



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Inxhinieri Elektrike”
“Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Aida Spahiu

Dr. Lindita Dhamo

Mars/2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 124, datë 17.2.2010, si Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) në Inxhinieri Elektrike
5	Urdhëri/Vendim/VKM i riorganizimit:	-
6	Regjistrimi i formës së diplomës:	UMASR Nr. 439, datë 09.09.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	S’ka
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	JO
13.1	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Për vitin akademik 2020-2021 Stafi akademik përbëhet nga: 17 PAE / 3 PAK (ne proces rekrutimi)
16	Numri i studentëve 2018-2021:	131 Studentë
17	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë është institucion i arsimit të lartë publik i **licencuar**: VKM Nr. 105, datë 28.02.1994 me emërtimin "Universiteti i Vlorës" dhe është riorganizuar me VKM Nr. 822, datë 05.12.2007 me emërtimi "Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë".

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë është ri-akredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit, BA Nr. 50, datë 27.11.2020, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.11.2025.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka 4 njësi kryesore:

1. Fakulteti i Ekonomisë me tre departamente dhe një qendër kërkimore.
2. Fakulteti i Shkencave Humane, me katër departamente dhe një qendër kërkimore.
3. Fakulteti i Shëndetit, me dy departamente dhe një qendër kërkimore.
4. Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, me shtatë departamente dhe një qendër kërkimore

Ky program studimi është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 124, datë 17.2.2010 si Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) në Inxhinieri Elektrike.

Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Elektrike" mbështetet nga njësia bazë Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare dhe njësia kryesore Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore. Programi ka pësuar ndryshime në masën 20%, në vitin akademik 2018-2019, ndryshime të miratuara me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 43, datë 12.07.2018 dhe miratuar me shkresë MASR Nr, 8327/2, datë 18.09.2018.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” të ofruar nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare dhe njësis kryesore Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Grupi, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, shqyrtoi Raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë gjetjesh që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, në dakortësi edhe më Universitetin e Vlorës realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL online, në datën 24-25 Nëntor 2020. Në këtë vizitë online, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u takua nëpërmjet *platformës Cisco* në takime të veçanta me: Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, sekretarinë mësimore, Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Edukimit për Ciklin e I& II, intervistë me studentët, vëzhgimi i mjediseve të institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj.,

Gjatë takimeve u bënë pyetje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë.

Pas vizitës online në IAL, GVJ filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe dhe të kërkuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Shënim: Për shkak të Pandemisë së COVID-19, komunikimi me IAL Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 datë 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.

Më datë 08.03.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 1/18 Prot., datë 11.03.2021 “*Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm*”, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UV përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 367/8 Prot., datë 16.03.2021 “*Përcjellje e komenteve mbi draft Raportin e vlerësimit të jashtëm*”.

Në këtë dokument institucioni ka disa komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. GVJ, pasi u njoh me komentet e UV sqaron si më poshtë:

1. **(Standardi II.4, Kriteri 1) GVJ konstaton:** Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm janë:
 - Viti i parë, semestri i parë 25 orë mësimore/javë, 50 minuteshe
 - Viti i parë, semestri i dytë 27 orë mësimore/javë bashkë me detyrën e kursit, 50 minuteshe
 - Viti i dytë, semestri i parë 24 orë mësimore+3 orë detyrë kursi/javë, 50 minuteshe
 - Viti i dytë, semestri i parë 23 orë mësimore+2 orë detyrë kursi/javë, 50 minuteshe
 - Viti i tretë, semestri i parë 24 orë mësimore+5 orë detyrë kursi/javë, 50 minuteshe
 - Viti i tretë, semestri i parë 22 orë mësimore+4 orë detyrë kursi/javë, 50 minuteshe

Ngarkesë mësimore javore është më e lartë se ajo e parashikuar nga VKM 41, pika 2.1.c ku kërkohet që ngarkesa javore të jetë deri në 25 orë mësimore.

DITD komenton: Detyra e kursit nuk është për fshirë si orë në auditor. Kjo vihet re edhe tek totali i orëve “Në auditor” dhe “Jashtë auditorit”. Është dakortësuar në nivelin stitucional që detyra e kursit të jepet gjatë orëve të leksioneve/seminareve dhe të konsiderohet punë jashtë auditorit.

Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm janë:

- Viti i parë, semestri i parë 25 orë mësimore/javë, 50 minuteshe
- Viti i parë, semestri i dytë 25 orë mësimore/javë, 50 minuteshe.
- Viti i dytë, semestri i parë 24 orë mësimore/javë, 50 minuteshe
- Viti i dytë, semestri i parë 23 orë mësimore/javë, 50 minuteshe
- Viti i tretë, semestri i parë 24 orë mësimore/javë, 50 minuteshe
- Viti i tretë, semestri i parë 22 orë mësimore/javë, 50 minuteshe

Ngarkesë mësimore javore në auditor nuk është më e lartë se 25 orë.

Komenti i GVJ: GVJ mendon se bazuar në Udhëzimin Nr. 29 datë 10.09.2018, Seksioni 1. VEPRIMTARIA QE KRYEN PERSONELI AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, pika 4, a. Veprimtarinë në auditor si vijon: vi. Projekte kursi. vii. Detyre kursi; detyra e kursit/projekti i kursit nuk mund të konsiderohen orë jashtë auditorit siç argumentohet në shkresën e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, datë 16.03.2021.

Sic kemi rekomanduar dhe në raport GVJ, UV në Rregulloren e institucionit duhet të këtë një ndarje institucionale të krediteve në orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, sipas veprimtarive mësimore në auditor, të konsideruara të tilla nga Udhëzimi Nr. 29, e cila mungon. **Për këtë arsye komenti i IAL nuk pranohet dhe RVJ nuk ndryshon.**

2. **(Standardi II.5, Kriteri 1) GVJ konstaton:** Numri mesatar i lëndëve/moduleve semestrare që mban një pedagog është 5 lëndë.


Mbeshtetur në udhëzimin 29, datë 10.09.2018, Seksioni II, pika 6: Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbajë në një vit akademik me shume se 3 lëndë semestrare. Ky kriter nuk plotësohet pasi ka pedagogë që kanë më shumë se 3 lëndë semestrare. Ka pedagogë që kanë ngarkesë më shumë se: ngarkesa në funksion titull/gradë + 200 orë suplementare në auditor.

Kriteri në lidhje me ngarkesën mësimore dhe numrin e moduleve që mund të mbajë një pedagog **nuk plotësohet.**

DITD komenton: Numri i lëndëve/moduleve që personeli akademik kanë një semester është në përputhje me udhëzimin 29, datë 10.09.2018, Seksioni II, pika 6, të ndryshuar me udhëzimin 37, datë 04.12.2018, pika a. Personeli akademik nuk ka më shumë se 3 lëndë/module në një semester (6 lëndë semestrare në një vit akademik) me përjashtim të një rasti kur lënda “Matje Elektrike”, për shkak të riorganizimit të programit u realizua në të njëjtën semester në dy vite të ndryshme. Për këtë rast, në diskutimet në department u dakortësua që të konsiderohet e njëjta lëndë.

Tabela 4 e RVB, ka të përfshirë parashikimin e ngarkesës mësimore në fillim të vitit, por për shkak të pushimeve zyrtare nuk tej kalohen +200 orë.

Komenti i GVJ: GVJ mendon se bazuar në udhëzimin 37, datë 04.12.2018, pika a.ku jepet riformulimi i pikës 6 të Udhëzimit 29 lejohet të mbahen deri në 3 (tre) lëndë në semestër. Mbetek komenti që ka ngarkesë të PAE mbi 200 ore nga ngarkesa e caktuar ne udhëzimin 29 pasi ngarkesa mësimore kur parashikohet nuk merr parasysh pushimet zyrtare, por ngarkesën në orë mësimore sipas krediteve dhe ndarjes në kredite të lëndës. Për këtë arsye komenti i IAL në lidhje me numrin e lëndëve pranohet ndërsa për parashikimin e ngarkesës ngelet i njëjtë dhe **RVJ ndryshon vetëm për pjesën e parë.**



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e Institucionit, gjë e cila reflektohet në Statutin e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë (UV).</p> <p>Në Statutin e UV, neni 4, pika 1 shprehet qartë se UV ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetin ligjor.</p> <p>Në Statutin e UV, neni 4, pika 2 shkruhet se “UV-ja synon zhvillimin e veprimtarisë së saj brenda sistemit arsimor e të kërkimit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar, duke u angazhuar në organizma/veprimtari të përhershme dhe të përkohshme në fushën përkatëse brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” nuk bien ndesh me interesat kombëtare</p>			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Në Statutin e UV, neni 5 shkruhet se “UV përfshin në programet mësimore e studimore traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, të gërshetura me standartet dhe arritjet më të mira botërore përgjithësisht etj.”</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, që ofrohet nga UV synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare.</p>			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e UV. UV ka mision të ofrojë programe studimi në fusha studimi të ndryshme, referuar niveleve 5, 6, 7, 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Statuti UV, neni 3. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” është program i nivelit 6 të KSHK.</p>			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>UV ka mision të ofrojë programe studimi për formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkenctarëve të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, Statuti UV, neni 3.</p> <p>UV ka mision të ofrojë shërbime me ndikim në publik dhe në komunitet, si dhe shërbime për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, Statuti UV, neni 3.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>UV ka përcaktuar në Startegjine 2018 – 2024, pjesa 2. 4, Kurrikulat, se ofron programe studimit Bachelor, këto programe ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, bazuar në sfidat e ekonomisë së tregut, për t'i pajisur dhe aftësuar studentët me njohuri që u lehtësojnë qasjen në tregun kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.</p> <p>Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD), i cili mbështet këtë program studimi, në planin e vet strategjik 2018-2024, 2.4.2, Kurrikula, ofron programe studimi Bachelor, të cila janë në zbatim të strategjisë së institucionit. Ky paragraf është njësoj si tek Strategjia e UV.</p>			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Misioni Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë:</p> <p>a) ofrimin e programeve të studimit në fusha të ndryshme në të tri ciklet e studimit të arsimit të lartë, si dhe programe studimi me karakter profesional, referuar niveleve 5, 6, 7, dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;</p> <p>Statuti i UV neni 6, UV-ja në përputhje me objektivat e saj, të politikës kulturore, të kërkimit, të mësimdhënies dhe në respektimin e lirisë së secilit, harton programe dhe projekte specifike sipas nevojave të fushave të ndryshme. Konkurren me këto projekte në planin kombëtar për financimin e kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor, si dhe në planin ndërkombëtar.</p> <p>Statuti i UV Neni 9: Njësitë kryesore:</p> <p>1. Fakultetet ofrojnë programe studimi të cikleve të ndryshme dhe miratojnë kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, sipas propozimeve të njëjësive bazë, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore.</p> <p>2. Fusha specifike e secilës njësi kryesore përcaktohet në rregulloren e universitetit.</p> <p>5. Disiplinat mësimore, fushat e kërkimit shkencor dhe struktura organizative e secilit departament përcaktohen në rregulloren e universitetit.</p> <p>Neni 56: Ciklet dhe programet e studimit</p> <p>5. Në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë programet e studimeve të ciklit të parë hartohen dhe propozohen nga njësitë baze, sipas nevojave dhe specifikës së çdo fushe përkatëse.</p> <p>Drejtimit prioritar akademike të tij përcaktohen në rregulloren e UV.</p>			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	<p>Në rregulloren e programit të studimit, Bachelor në "Inxhinieri Elektrike" neni 3 jepet emërtimi, organizimi por jo struktura e këtij programi studimi. Në nenin 5 ku jepet kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë këtë program studimi të ciklit të parë jepen vetëm përkufizimet, por jo ndarja në kredite për këtë program sipas kategorive të veprimtarive formuese.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
				X

Standardi I.3**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, neni 4, janë dhënë objektivat formuese të programit të studimit por jo kompetencat profesionale në mënyrë të shtjelluar, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Mundësitë e punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi janë dhënë tek Guida e studentit, pika 4, Rregullore e fakultetit neni 6.</p> <p>Nuk ka nje studim të tregut të punës në nivel lokal apo kombëtar.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në nenin 4 të Rregullores së programit të studimit duhet të jepeshin qartë objektivat formues të programit të studimit. Në këtë nen shkruhet që: Objektivat e programit përfshijnë formimin e inxhinierit me njohuri për të zgjidhur problemet ..., por pa i dhënë cilat janë këto objektiva formues.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike ka objektiva formues dhe përmbajtja e tij garanton përfundimin e dijeve, aftësive, e kompetencave që i nevojitet tregut të punës për këtë profesion dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> <p>Në Neni 4 të Rregullores së programit të studimit dhe në rregulloren në tërësi duhet të jepeshin qartësisht objektivat e përgjithshme, ato specifike, kompetencat dhe aftësitë që përfitojnë studentët nga ky program studimi, të cilat mungojnë.</p> <p>Në këtë nen theksohet se ky program studimi i nivelit 6 i aftëson studentët për të vazhduar studimet e tyre dhe në programet e studimit master, niveli 7.</p> <p>Në nenin 5 jepen kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë programin e studimit si përcaktime por jo në numër kreditesh për secilën kategori për këtë program studimi.</p> <p>Në planin mësimor të detajuar, RVB, tabela 10, jepet plani mësimor i ndarë në kredite dhe orë mësimore në auditor dhe përgatitje individuale, sipas aktiviteteve mësimore të lëndës, leksion, seminar, detyrë, laborator.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Universiteti i Vlorës, është Institucion publik i Arsimit të Lartë dhe është krijuar në 10 tetor 1994, me VKM 105, datë 28.02.1994, në fillim me tre fakultete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Fakultet i Tregëtisë 2- Fakulteti i Inxhinierisë Detare 3- Fakulteti i Infermierisë <p>Universiteti i Vlorës është riorganizuar me VKM Nr. 822, datë 05.12.2007 me emërtimin "Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, UV sot ka 4 fakultete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Ekonomisë 2. Fakulteti i Shkencave Humane 3. Fakulteti i Shëndetit 4. Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore <p>Programi i studimit "Bachelor në Inxhinieri Elektrike" mbështetet nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (më tej DITD) në Fakultetin e Shkencave teknike dhe natyrore. Ky program studimi është hapur për herë të parë me VKM Nr. 124, datë 17.02.2010. Pra ka një periudhë prej 10 vite akademike.</p> <p>DITD ka në përbërjen e tij 10 personel akademik efektiv, PAE, 3 personel akademik me kontrate, PAK dhe 2 personel akademik ndihmës.</p> <p>Nga PAE 2 janë me titull Prof. Asc., 4 me grade shkencore Doktor, dhe 4 Msc. 1 personel ndihmesakademik laborante dhe 1 personel ndihmesakademik sekretare. Nga PAK të 3 janë me kualifikimin Msc.</p> <p>UV, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore (FSHTN) dhe DITD kanë përvojën, kapacitete dhe burimet e duhura në fushën e Inxhinierisë Elektrike, evidencë RVB, Aneksi 1, Tabelat përmbledhëse, tabela 1, tabela 2.1</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fushat e kërkimit shkencor në UV, përcaktohen nga njësitë bazë dhe ato kryesore, bazuar në fushat e prioritare të zhvillimit kombëtar dhe në programet e ofruara, Statuti neni 83, pika 3.</p> <p>Në Rregulloren e FSHTN, neni 3, Qëllime bazë shkruhet: Puna kërkimore shkencore dhe akademike në FSHTN zhvillohet brenda Departamenteve sipas njesive kërkimore/shkencore të krijuara prej tij. Specifikat e kërkimit shkencor zgjidhen të tilla që të jenë në përputhje me disiplinat ërkatëse të fushave të studimit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 2019, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Faqe 10

	<p>Në neni 5 të Rregullores së FSHTN, Programet e studimit, jepen programet e studimit që mbështeten nga kjo njësi kryesore ku një prej tyre është Bachelor në Inxhinieri Elektrike.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>								
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fushat e kërkimit shkencor në UV, përcaktohen nga njësitë bazë dhe ato kryesore, bazuar në fushat e prioritare të zhvillimit kombëtar dhe në programet e ofruara, Statuti neni 83, pika 3.</p> <p>Në strategjinë e DTID, seksioni 2.2. Roli dhe misioni, tregohet se misioni i saj është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e specialistëve dhe shkencëtareve të rinj në fushën e teknologjive detare, mekanike dhe elektrike. - Integrimi i mësimdhënies me kërkimin shkencor sipas fushave përkatëse. <p>Programi i studimi i përket klasës së 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe është i organizuar me 180 ECTS.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të DTID, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Programet e ciklit të parë në UV hartohen dhe propozohen nga njësitë bazë, sipas nevojave dhe specifikës së çdo fushe përkatëse. Propozimet e programeve të reja shqyrtohen dhe marrin një miratim paraprak nga Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme të Fakultetit (KSCBF) dhe i përcillen Senatit Akademik për miratim, referencë Statuti UV, neni 56, Ciklet dhe programet e studimit.</p> <p>Përgjegjëse për këtë program studimi është DTID, i cili ka ngritur dhe grupin mësimor kërkimor të Inxhinierisë Elektrike. Ky grup mësimor/kërkimor mbulon të gjitha lëndët profesionale të këtij drejtimi dhe të gjitha problematikat akademike dhe kërkimore shkencore të fushës së inxhinierisë elektrike, referencë I 8. Ngritja e grupeve mësimore.</p> <p>Programi i ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektrike realizohet me ndihmën e Departamenteve të tjera të FSHT, si: Departamenti i</p>

	<p>Matematikës, Fizikës, Kimisë, Shkencave Kompjuterike si dhe Departamenti i Gjuheve të huaja nga Fakulteti i Shkencave Humane, evidencë Lista e stafit akademik UV, II.11 CV e stafit akademik dhe ndihmësakademik.</p> <p>Mbikëqyrja për mbarëvajtjen e këtij programi studimi realizohet nga DITD, FSHTN, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe projekteve në UV, referencë evidenca I.14 dhe I.15.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>UV ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit si: Universiteti Liege, Belgjike, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Clausthal University of Technology, Atatürk University dhe Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, evidence I.10.</p> <p>GVJ mendon se në listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit duhet të jepej dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve. Marrëveshjet e bashkëpunimit përfshijnë mësimëdhënien dhe punën kërkimore.</p> <p><i>UV duhet të kishte vendosur marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës, si i vetmi Universitet publik që mbështet programin e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në fushën e Inxhinierisë Elektrike.</i></p> <p>UV ka nënshkruar dhe marrëveshje mirëkuptimi me Institucione të arsimit të lartë për periudhën 1997 – 2019, evidenca I.16 Evidentimi i rezultateve të MOU.</p> <p>Universiteti i Vlorës ka nënshkruar një protokoll bilateral në kuadër të programit të shkëmbimit Mevlana me Universitetin e Bingölit (<i>Bingöl University</i>), në Turqi. Studentët dhe stafi akademik i Universitetit të Vlorës mund të përfitojë nga ky program për të kryer studime për një semester apo për të dhënë leksione për dy javë në këtë universitet, 2019-2024, https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/student-dhe-staf-dales</p> <p>UV ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas, evidence I.10, I.17 dhe I.18. Vlen të theksohet se marrëveshjet e bashkëpunimit tek evidence I.18, me Tec-in e vlorës dhe OST Fier janë të lidhura drejtpërdrejtë me realizimin e objektivave formues të studentëve për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin e studimit, DITD në analizën vjetore harton raportin e punës vjetore për të gjithë komponentët e mësimëdhënies: projekte dhe marrëveshje ndërkombëtare, baza laboratorike, workshope, seminare, konferenca.</p> <p>Evidence I. 14, Analiza vjetore DITD.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>GVJ konstaton se UV ka vendosur marrëdhënie zyrtare bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. Evidence I.10, I.17 dhe I.18.</p> <p>Evidenca I.18 ka marrëveshje bashkëpunimi specifike për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për</p>	<p>Në materialet e vëna në sistemin AMS, GVJ nuk gjeti ndonjë material që të ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në</p>

studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	bashkërendim me punëdhënësit. I vetmi material është evidence I.19, Raporti i qendrës së zhvillimit rajonal, që lidhet me trajnimet për mësuesit, studentët e ciklit të dytë të shkencave kompjuterike dhe trainime stafi akademik për përdorimin e platformës MOODLE.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është i organizuar në lëndë, të cilat janë të vlerësuara në kredite në përputhje me LAL 80/2015 dhe VKM 41, datë 24.1.2018 “PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË” dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi organizohet në tre vite akademike (6 semestra) me 180 kredite, evidence I.3 Rregullore e programit të studimit, neni 2 dhe neni 3, neni 20, dhe karakterizohet nga veprimtaritë formuese të grupuara në: a) Lëndë bazë, b) Lëndë karakterizuese, c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese, d) Lëndë plotësuese, e) Detyrime përmbyllëse. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është riorganizuar deri në masën 20% me Vendimin e Senatit të UV Nr. 43, datë 17.07.2018, i miratuar nga MASR Nr. 8327/2, datë 18.09.2018, në përputhje të plotë me LAL 80/2015.
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike synon formimin profesional me njohuri të vçanta për të zgjidhur problem në fusha si: prodhimi i energjisë elektrike, transmetimi i energjisë elektrike, përdorimi i energjisë elektrike, aplikime të menaxhimit të energjisë elektrike, instalimet elektrike dhe mirëmbajtja e tyre, Evidence I.3 Rregullore e programit të studimit, neni 4.
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike jep njohuri në fushën e studimit dhe të punësimit si inxhinier elektrik. Kjo reflektohet nëpërmjet lëndëve të përfshira në programin e studimit si Elektroteknika, Makina elektrike, Bazat e Automatikës, Matje elektrike, shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike, Bazat e elektronikës, transmisionet

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 2019, Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 13

	<p>elektrike etj. ku përfshihen të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së Inxhinierisë Elektrike, Evidence I.7, Programi mësimor në Inxhinieri Elektrike dhe riorganizimi.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i ciklit të parë, Bachelor në Inxhinieri Elektrike, zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale, evidence I.3, Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit në përputhje me VKM 41, datë 24.1.2018 “PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË” si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lëndët janë në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); Programi ka në total 180 kredite, reference Rregullore e programit të studimit 2. Në rregulloren e programit të studimit, neni 9 jepen format e kontrollit të dijeve dhe instrumentet e vlerësimit. 3. Plani mësimor dhe kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, referencë riorganizimi i programit të studimit 2018-2019. 4. Kriteret dhe kuotat e pranimit, evidence II.3 5. Veprimtaritë formuese të programit të studimit, evidence I.3 Rregullore e programit të studimit, neni 8. 6. Programi lëndor i çdo lënde, evidence I. 6, Syllabuset 7. Diplomën dhe suplementin, evidence II. 1 Diploma dhe suplementi. 8. Realizimi i praktikës profesionale, evidence I.3 Rregullore e programit të studimit, neni 21. 9. Njohja e pjesshme ose e plotë e krediteve me qëllim transferimin nga një IAL tjetër në UV dhe në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, evidencë II. 7, Procedurë për transferimin e programit të studimit dhe programi i dytë studimi. 10. Zgjedhja si programi i dytë studimesh programin Bachelor në Inxhinieri Elektrike, evidencë II. 7. 11. Rregullore e diplomimit, evidencë II. 12 Rregullore e diplomimit; III. 22, Fondi i temave orientuese për provimin e formimit. <p>Objektivat formues dhe kompetencat profesionale në Rregulloren e programit të studimit duhet të jepen në përputhje me përcaktimet e VKM 41, evidence I.3, Rregullore e programit të studimit, neni 4.</p>

<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike I ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke i grupuar lëndët e planit mësimor sipas përcaktimeve të VKM 41, datë 24.1.2018, Shtojca Nr. 1, Tabela 1. Veprimtaritë formuese për Ciklin e parë Bachelor.</p> <p>A. LËNDË BAZË (15% - 20%) – 36 kredite, (20%)</p> <p>B. LËNDË KARAKTERIZUESE (50% - 55%) – 96 kredite, (53%)</p> <p>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE (12% - 15%) – 24 kredite, (13%)</p> <p>D. LËNDË PLOTËSUESE (10% - 15%) – 18 kredite, (10%)</p> <p>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE (3% - 5%) – 6 kredite, (3.3%)</p> <p>Evidence, I. 7. Programi mësimor dhe riorganizimi i programit të studimit.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë është akredituar për herë të parë me Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 71, datë 21.09.2017, me kohëzgjatje 3 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 30.09.2020.</p> <p>Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë është ri-akredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit, BA Nr. 50, datë 27.11.2020, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.11.2025.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Në Statutin e UV, neni 77, dhe Rregulloren e DITD, neni 6 Koordinator i marrëdhëniet me studentin shkruhet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Koordinator i marrëdhëniet me studentin është anëtar i stafit akademik të njësisë bazë, i emëruar nga drejtuesi i njësisë bazë, për të koordinuar marrëdhëniet e departamentit me studentët. 2. Koordinator kryen promovimin e programeve të studimit të ofruara nga njësia bazë. Informon, orienton dhe këshillon studentët për veprimtarinë mësimore, kërkimore- shkencore dhe aktivitete të tjera. 3. Koordinator ofron këshillim për zhvillimin e karrierës në njësinë bazë. 4. Ai këshillon studentët për problematika të ndryshme dhe raporton problematikat e tyre në departament. <p>Sipas përcaktimeve të statutit dhe Rregullores së DITD është vetëm një koordinator për të gjitha programet e studimit që ofron DITD.</p> <p>Njësia kryesore dhe njësia bazë duhet të caktojë një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit duhet të informoj vazhdimisht Drejtuesit e DITD.</p>

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Njësia kryesore që mbështet këtë program studimi të ciklit të parë, FSHTN përbëhet nga shtatë Departamente:

5. Departamenti i Matematikës
6. Departamenti i Fizikës
7. Departamenti i Kimisë
8. Departamenti i Biologjisë
9. Departamenti i Shkencave Kompjuterike

10. Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare

11. Departamenti i Shkencave Detare

FSHTN përmbush detyrimet ligjore të LAL 80/2015, neni 23, pika 1 dhe 2. FSHTN ka 7 departamente nga 3 të kërkuara. Departamentet e FSHTN bashkërendojnë punën mësimore me njëra tjetrën në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike. Evidence I. 9, Rregullore e fakultetit, Kreu II, neni 4.

Për vitin aktual 2020-2021, Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang Fakulteti, 73 pedagogë të ndarë në 69 PAE dhe 7 PAK përbëhet nga:

	PAE	PAK
Profesor	1	-
Prof. Asoc	8	2
Doktor/Docent	31	2
Msc.	29	3
	69	7

DITD është e organizuar në dy grupe mësimore kërkimore:

- a) Grupi i Inxhinierive Mekanike dhe Navale
- b) Grupi i Inxhinierisë Elektrike

Evidenca I.8 Ngritja e grupeve mësimore kërkimore.

DITD përmbush detyrimet ligjore të LAL 80/2015, neni 25, pika 4 ku duhet të ketë të paktën 7 anëtarë nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë dhe neni 25, pika 5, Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore.

Njësia kryesore FSHT dhe ajo bazë DITD përgjegjëse për këtë program studimi, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin e programit të studimit.

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

DITD, njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi ka në përbërjen e saj, 10 personel akademik efektiv (PAE), 2 ndihmës akademik, 1 laborant dhe 1 sekretare dhe 2 personel akademik me kontrate PAK, **referencë**

Tabela-aneksi i perditesuar.

Për gjatë viteve të fundit DITD, ka të dhënat si më poshtë:

Në vitin akademik 2017–2018:

	<ul style="list-style-type: none"> - 12 PAE (2 Prof. Asoc., 4 Dr. dhe 6MSc). - 2 PAK (1 Prof.Dr. dhe 1 MSc). <p><u>Në vitin akademik 2018–2019:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 11 PAE (2 Prof. Asoc., 4 Dr. dhe 5 MSc). - 3 PAK (3 MSc). <p><u>Në vitin akademik 2019–2020:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 PAE (2 Prof. Asoc., 4 Dr. dhe 4 MSc) - 3 PAK (3 Msc); <p><u>Në vitin akademik 2020–2021:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 PAE (2 Prof. Asoc., 4 Dr. dhe 4 MSc) - 3 PAK (ne proces rekrutimi). <p>DITD përmbush detyrimet ligjore të LAL 80/2015, neni 25, pika 4 ku duhet të ketë të paktën 7 anëtarë nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë.</p> <p>Drejtuesi i DITD, është me titull akademik “Profesor i Asociuar”, i kategorisë “Profesor” në përputhje me nenin 45, pika 3 të LAL 80/2015.</p> <p>PAE dhe PAK aktivizuar për këtë program studimi kanë minimum kualifikimin Master i Shkencave, në përputhje të plotë me nenin 59, pika 6 të LAL 80/2015.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Shkalla e përmbushjes së standardit</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>FSHTN si njësia kryesore që mbështet këtë program studimi të ciklit të parë në <i>rregulloren e saj, Kreu V, Organizimi i studimeve universitare</i>, jep informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, të cilat janë të organizuara në module dhe të vleresuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), sasia mesatare e krediteve të grumbullura gjatë një viti akademik nga një student me kohë të plotë është 60 kredite, një krediti të studimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore, transferimi dhe ekuivalentimi i studimeve, viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies; frekuentimi i orës mësimore dhe detyrimi i paraqitjes në provim.</p> <p>Në kreun VI, Kontrolli i dijes, jepet informacion në lidhje me sistemin e vlerësimit, Rregullat e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimi, mbrojtja e tezës së diplomës.</p> <p>DITD, njësia bazë që e ofron këtë program studimi në rregulloren e saj, neni 15, Programet e studimit të ciklit të parë, ku jepet informacion i plotë mbi organizimin në tre vite akademike, me 180 kredite, kriteret dhe kuotat e</p>

	<p>pranimi. Në nenin 18 jepet sistemi i vlerësimit të njohurive të studentëve, nën 20, Praktikat profesionale.</p> <p>Informacion i plotë në lidhje me organizimin, strukturën e programit të studimit jepet në Regulloren e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike si: <i>Emërtimi dhe statusi i programit; Objektivat formuese të programit të studimit, nën 5, Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë programin e studimit "Bachelor në Inxhinieri Elektrike"; Kodifikimi i lëndëve në programin dhe planin mësimor, nën 6; Syllabuset e lëndëve, Format dhe organizimi i studimit të programit "Bachelor në Inxhinieri Elektrike"; orari i studimit dhe provimet, kreditet, nën 20, praktika profesionale etj.</i></p> <p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike jepet në Evidencën I.7 Programi mësimor dhe riorganizimi. Në këtë evidencë jepen plani mësimor për këtë program studimi. Planin mësimor i detajuar jepet në <u>RVB, tabela 10.</u></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është i organizuar në lëndë, praktikë e aktivitete formuese, duke i grupuar lëndët e planit mësimor sipas përcaktimeve të VKM 41, datë 24.1.2018, <u>Shtojca Nr. 1, Tabela 1. Veprimtaritë formuese për Ciklin e parë Bachelor.</u></p> <p>A. LËNDË BAZË (15% - 20%) – 36 kredite, (20%) B. LËNDË KARAKTERIZUESE (50% - 55%) – 96 kredite, (53%) C. LËNDË NDËRDISIPLINORE (12% - 15%) – 24 kredite, (13%) D. LËNDË PLOTËSUESE (10% - 15%) – 18 kredite, (10%) E. DETYRIME PËRMBYLLËSE (3% - 5%) – 6 kredite, (3.3%)</p> <p>% e lëndëve bazë dhe karakterizuese është 73% pra më shumë se 70% në përputhje me VKM 879, datë 18.12.2019.</p> <p><u>Evidence, I.7, Programi mësimor dhe riorganizimi i programit të studimit.</u></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite në përputhje me LAL 80/2015, VKM 41, datë 24.1.2018 dhe VKM 879, datë 18.12.2019 “Disa ndryshime në Vendimi Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.</p> <p>Ky program studimi është i organizuar në tre vite akademike dhe 6 semestra ku studentët grumbullojnë në total 180 kredite. Çdo semester organizohet në lëndë të vlerësuara në 30 kredite ndërsa viti akademik në 60 kredite. Kohëzgjatja e një semestri është 15 javë mësimore.</p> <p><u>Evidence, I.7, Programi mësimor dhe riorganizimi i programit të studimit; Evidenca II.1 Diploma dhe suplementi i diplomës.</u></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfaqësohen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike përmban planin mësimor, <u>Evidence, I.7, Programi mësimor dhe riorganizimi i programit të studimit, RVB, tabela 10.</u></p> <p>Në planin mësimor jepet informacion: viti ku realizohet lënda, semestri, kodi i lëndës, emërtimi i saj, kreditet në total për lëndën, totali i orëve në</p>

<p>programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>auditor dhe jashtë auditorit, totali i orëve javore sipas veprimtarisë: leksion, seminar, laborator, detyrë kursi, <u>referencë plani mësimor 2018-2019.</u></p> <p>Në planin mësimor, <u>evidence RVB, tabela 10</u> jepet ndarja në kredite sipas veprimtarisë: leksion, seminar, laborator, detyrë kursi si dhe orët mësimore përkatëse për secilën veprimtari.</p> <p>Në <u>Rregulloren e UV</u> ose të fakultetit duhet të jepej informacioni në lidhje me ndarjen e orëve mësimore për 1 kredit (25 orë), se sa orë ato kanë vendosur të zhvillohen <u>në auditor</u> dhe sa orë <u>studim i pavarur jashtë auditorit</u>, për leksionet, seminarët, laboratorët, projektet e kursit, praktikën profesionale, provimin përfundimtar, etj.</p> <p>Këtë informacion nuk e gjetëm dhe në dokumentat e tjera të vëna në sistem si: Statuti i UV, Rregulloren e FSHTN, DITD apo Rregulloren e programit të studimit.</p> <p><u>Por nga plani mësimor rezultojnë kjo ndarje:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksionet, kanë ndarjen: 12.5 orë mësimore në auditor dhe 12.5 orë mësimore jashtë auditorit. Në disa lëndë ato kanë ndarje tjetër 10.7 orë mësimore në auditor dhe 14.3 orë mësimore jashtë auditorit; - Seminarët, laboratorët kanë ndarjen: 12.5 orë mësimore në auditor dhe 12.5 orë mësimore jashtë auditorit
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p><u>Në statutin e UV</u> jepet informacion në nenin 59 në lidhje me pranimin në programet e ciklit të parë, në nenin 69 mbi Transferimi i studimeve, njohja dhe njësimi i periudhave të studimit.</p> <p><u>Në rregulloren e FSHTN</u>, neni 21, jepet informacion në lidhje me transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve si: ngritja e komisionit të ekuivalentimit nga departamenti që mbështet programin e studimit apo si realizohet ekuivalentimi i krediteve dhe njohja e tyre, <u>Evidenca I.9.</u></p> <p><u>Në rregulloren e DIDT</u>, neni 15 jepet informacion në lidhje me kriteret e përgjithshme të pranimit në këtë program studimi, <u>Evidenca I.2</u></p> <p><u>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike</u> jepet informacion në lidhje me kuotat, tarifatat dhe pranimi i studentëve në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike përmban programet lëndore për secilën lëndë, <u>Evidencë I.6</u>, syllabuset e programit të studimit.</p> <p>Programet lëndore, syllabuset për secilën lëndë janë hartuar në përputhje me VKM 41, datë 24.1.2018. Ato përmbajnë komponentët e kërkuara si: emërtimi i lëndës, Ngarkesa: (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, laboratore etj.); Titullari /pedagogu i lëndës: (emri, titulli akademik, grada shkencore dhe nënshkrimi); Tipologjia e lëndës: Viti akademik/semestri kur zhvillohet; Lloji i lëndës: (e detyrueshme ose me zgjedhje); Programi i studimit: (programi për të cilin ofrohet kjo lëndë); Kodi i lëndës: Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës; etj.</p> <p>Në syllabuse, GVJ konstaton disa pasaktësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në syllabuset duhet të jepet dhe titullari i lëndës, i cili mungon

	<ul style="list-style-type: none"> - Në syllabuse paragrafi “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit” sipas modelit, Shtojca Nr. 3 e VKM 879, datë 18.12.2019 duhet të përmbajë objektivat të ndara në njohuri, aftësi dhe kompetenca. - Disa syllabuse i kanë, numrin e faqeve sipas literaturës përkatëse ndërsa në disa të tjera mungon. - Syllabuset e lëndëve duhet të përmbajnë elemente të Kodit të Etikës si: detyrimi që kanë studentët për të mos kopjuar punën e të tjerëve, për të respektuar personelin akademik, atë ndihmës, studentët e tjerë etj. Ky element është i përshkruar shumë mirë në syllabusin e lëndës “Kimi e përgjithshme”. - Në disa lëndë nuk ka informacion në lidhje me orët mësimore për 1 kredit leksion, seminar, laborator dhe detyrë. Kështu përshembull lënda: “Fizikë” me 6 kredite e ndarë: 3 orë leksione në javë/1 orë seminar në javë/1 orë laborator në javë ndërsa Lënda “Hyrje në programim” me 8 kredite me të njëjtën ndarje: 3 orë leksione në javë/1orë seminar në javë/1 orë laborator në javë. - Lënda “Kimi e përgjithshme” me 6 kredite e ndarë: 3 orë leksione në javë/2 orë seminar në javë. Kjo lëndë nuk ka kredit laborator në ndarjen e lëndës ndërkohë ka të vendosur në syllabus temat e laboratorëve. Nga kjo lëndë konstatojmë se ndarja punë në auditor dhe jashtë auditorit nuk është e duhura: 6 kredite x 25 ore/kredit =150 ore nga këto 75 orë janë në auditor dhe 75 orë janë jashtë auditorit. Në tabelë është vendosur 125 orë jashtë auditorit, studim individual dhe total për 6 kredite janë 200 orë. - Lënda “Analiza matematike 2” me 8 kredite ka të njëjtën ndarje me lëndën me 6 kredite ndarje: 3 orë leksione në javë/2orë seminar në javë. - Lënda “Grafikë Inxhinierike” me 6 kredite ka ndarje tjetër nga Lënda fizikë po me 6 kredite ku është shtuar dhe detyra e kursit, që sigurisht duhet të ketë kredite: 6 kredite me të njëjtën ndarje: 3 orë leksione në javë/1orë seminar në javë/detyrë kursi. - Lënda “PLC” me 6 kredite ka ndarje: 3 orë leksione në javë/1orë seminar në javë. - Lënda “Elektroteknikë 2” me 8 kredite ka të shtuar 1orë seminar në javë krahasuar me lëndë “Hyrje në programim” me të njëjtin numër kreditesh nga: 3 orë leksione në javë/2orë seminar në javë/1 orë laborator në javë. - Lënda “Teknologjia e materialeve elektrike” nuk ka kredit për detyrë kursi ndërkohë në syllabus janë dhënë temat për detyrën e kursit. - Në lëndët “Termodinamikë e aplikuar”, “Bazat e Elektronikës”, “Matje Elektrike”, “Makinat Elektrike”, “Mekanika e aplikuar”, “Elektronika Industriale”, “Shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike”, “Bazat e Automatikës 1”, “Sistemet elektrike”, “Transmisione elektrike”, “Teknologjia e materialeve elektrike”, “Bazat e Automatikës 1”, “Burimet e rinovueshme të energjisë elektrike” “Cilësia, normativat dhe legjislacioni teknik”, “Shpërndarja
--	---

	dhe përdorimi i energjisë elektrike” mungon numri i krediteve për lëndën, i cili është detyrim nga Shtojca 3 e VKM 879, datë 18.12.2019 dhe modelit të VKM 41.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>Në sistem është vënë Programi i përmirësuar i studimit deri në masën 20%, Evidenca I.7.</p> <p>DITD bën çdo vit analizën e programit të studimit dhe planin e masave për përmirësimin e cilësisë së programeve që mbështet, <u>evidencë III.4.</u></p> <p>Përmirësimi i këtij programi studimi është bërë me qëllim të përafrimit të tij me programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, që zhvillohet në Universitetin Politeknik të Tiranës. Duke qenë se DITD nuk ofron program të ciklit të dytë në fushën e Inxhinierisë Elektrike, studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike në UV e vazhdojnë atë pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike në Universitetin Politeknik të Tiranës, UPT.</p> <p>Përmirësimi i programit të studimit sjell një ndryshim më të vogël kreditesh midis programeve të ciklit të parë të zhvilluar në UV dhe UPT si rrjedhojë studentët që përfundojnë këtë program studimi e kanë më të lehtë të vazhdojnë ciklit e dytë të studimeve pranë UPT.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Ngarkesa e programit të studimit Bachelor në inxhinieri Elektrike është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore të ligjit 80/2015, neni 70, neni 73 dhe VKM 41 datë 24.1.2018.</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite dhe 30 kredite për një semestër. Çdo semestër ka 15 javë mësimore</p> <p>Si program i ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, është i organizuar me 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tij është tri vite akademike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin e parë ngarkesa është e ndarë 50% në auditor dhe 50% punë të pavarur. - Për vitin e dytë ngarkesa është e ndarë 47% në auditor dhe 53% punë të pavarur. - Për vitin e tretë ngarkesa është e ndarë 43% në auditor dhe 57% punë të pavarur.

	<p>Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1 500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore.</p> <p>Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti i parë, semestri i parë 25 orë mësimore/javë, 50 minuteshe - Viti i parë, semestri i dytë 27 orë mësimore/javë bashkë me detyrën e kursit, 50 minuteshe - Viti i dytë, semestri i parë 24 orë mësimore+3 orë detyrë kursi/javë, 50 minuteshe - Viti i dytë, semestri i parë 23 orë mësimore+2 orë detyrë kursi/javë, 50 minuteshe - Viti i tretë, semestri i parë 24 orë mësimore+5 orë detyrë kursi/javë, 50 minuteshe - Viti i tretë, semestri i parë 22 orë mësimore+4 orë detyrë kursi/javë, 50 minuteshe <p>Ngarkesë mësimore javore është më e lartë se ajo e parashikuar nga VKM 41, pika 2.1.c ku kërkohet që ngarkesa javore të jetë deri në 25 orë mësimore.</p> <p>Evidencë I.7 Programi mësimor në inxhinieri elektrike dhe riorganizimi.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike emërtimi përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktika profesionale mundësojnë njohuri dhe aftësi për punësimin e studentëve.</p> <p>Praktika profesionale zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të tretë.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Lëndët e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, janë të shpërndara në 6 semestra dhe tre vite akademike. Lëndët janë të vlerësuar në kredite dhe orë mësimore sipas aktiviteteve, leksion, seminar, laborator dhe detyrë kursi që mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> <p>Në vitin e parë janë vendosur lëndë bazë si Matematikë, Fizikë, Kimi dhe lëndë plotësuese si Gjuhë e huaj dhe Hyrje në programim, në vitin e dytë janë të vendosura lëndë ndërdisiplinore dhe karakterizuese dhe në vitin e tretë janë të vendosura lëndë karakterizuese dhe praktika profesionale.</p> <p>Në planin mësimor jepet numri i krediteve për çdo lëndë, numri total i orëve në auditor dhe orët për punë të pavarur, orët javore për çdo aktivitet mësimor, leksione, seminar, laborator dhe detyrë kursi,</p> <p>Në planin mësimor, <u>RVB</u>, tabela 10, jepet dhe ndarja në kredite sipas aktiviteteve mësimore, dhe orët mësimore.</p> <p>Në të gjitha dokumentat e vëna në dosjen e vetëvlersimit mungon informacion në lidhje me ndarjen 1 kredit leksion – orë mësimore, 1 kredit seminar – orë mësimore, 1 kredit laborator – orë mësimore, 1 kredit detyrë – orë mësimore.</p>

<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, lëndët dhe emërtimi i tyre është në përputhje me profilin e programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti teori praktikë për lëndët e vitit të parë mesatarisht është 57.7% teori dhe 42.3% praktikë. - Raporti teori praktikë për lëndët e vitit të dytë është 52% teori dhe 48% praktikë. - Raporti teori praktikë për lëndët e vitit të tretë është 43.6% teori dhe 56.4% praktikë, <p>Evidencë I.7 Programi mësimor dnë inxhinieri elektrike dhe riorganizimi.</p> <p>Programi i studimit i riorganizuar ka një ngjashmëri mbi 70% me Programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike që ofrohet nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike në Universitetin Politeknik, në përputhje me LAL 80/2015, neni 86, pika 2.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor i riorganizuar i këtij programi studimi me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 43, datë 17.07.2018 ka përmirësuar ndarjen sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik. Ky planë mësimor i riorganizuar i ka përafëruar emërtimet e lëndëve në një masë të madhe me ato të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike sipas drejtimeve përkatëse që zhvillohet në Fakultetin Inxhinierisë Elektrike, Universiteti Politeknik i Tiranës.</p> <p>Kjo bën të mundur transferimin e studimeve, mobilitetet e studentëve dhe punësimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/ moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve, <u>evidence I.6</u>, shumica e lëndëve në literaturën e vendosur nuk kanë vitin e botimit.</p> <p>Në lëndët ku është e vendosur literature ajo nuk është e pesë viteve të fundit.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programit Bachelor në Inxhinieri Elektrike garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> <p>Dijet e përfuara, aftësitë dhe kompetencat e përfuara duhet të shprehen më qartë dhe në mënyrë të dukshme në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi, në përputhje me Shtojcën 3, të VKM 879 datë 18.12.2019</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregu e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit Bachelor në Inxhinieri Elektrike mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë Master Profesional ose Master i Shkencave.</p> <p>Inxhinieria elektrike është një fushë e kërkuar për punësim në Shqipëri. Për të gjykuar më mirë në lidhje me punësimin e studentëve që diplomohen nga ky program studimi duhet të ishin vënë të dhëna në DVV se sa nga studentët që kanë mbaruar këtë program studimi janë të punësuar në fushën e inxhinierisë elektrike.</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregu e punës,</p>	<p>Drejtorja e sigurimit të brendshëm të cilësisë në UV ka organizuar workshop me temë: “Studentët dhe tregu i punës”. Qëllimi i workshop ka qenë përmirësimi i përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatja sa më e mirë e tyre me tregun e punës, <u>evidencë II.10</u></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 2019, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 23

strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Në Dosjen e VV nuk ka evidencë në lidhje me konsultimin specifik të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës për këtë program studimi, me qëllim përshtatjen sa më të mirë të përmbajtjes së programit të studimit me kërkesat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																				
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik PAE dhe PAK i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin e duhur për këtë program studimi. Minimumi i kualifikimit të personelit akademik, për këtë program studimi të ciklit të parë, në përputhje me LAL 80/2015 është Master i Shkencave. Kjo kërkesë ligjore plotësohet plotësisht.</p> <p>Në realizimin e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” janë përfshirë personel akademik efektiv, personel akademik me kontratë dhe personel ndihmës akademik. Në katër vitet e fundit angazhimi i personelit akademik në mësimdhënie, në këtë program studimi dhe kualifikimi i tyre përkatësisht është si më poshtë: [Evidencat tabelat e perditësuara]:</p> <table border="1" data-bbox="635 1086 1337 1310"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi</th> <th colspan="2">2017-2018</th> <th colspan="2">2018-2019</th> <th colspan="2">2019-2020</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th rowspan="2">Në proces rekrutimi</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Prof As</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Dr.PhD</td> <td>6</td> <td>-</td> <td>7</td> <td>-</td> <td>6</td> <td>-</td> <td>8</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>11</td> <td>-</td> <td>9</td> <td>2</td> <td>12</td> <td>2</td> <td>8</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Totale</td> <td>18</td> <td>1</td> <td>17</td> <td>2</td> <td>19</td> <td>2</td> <td>17</td> <td>-</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga verifikimi i personelit akademik i përfshirë në mësimdhënie, konstatohet një qëndrueshmëri në stafin akademik.</p> <p>Nga verifikimi i të dhënave statistikore, u konstatua se për vitet e fundit mbi 91.42% e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv. Evidence RVB, tabela 4.</p> <p>Numri mesatar i lëndëve/moduleve semestrale që mban një pedagog është 5 lëndë, Evidence RVB, tabela 4.</p> <p>Mbeshtetur ne udhëzimin 37, datë 04.12.2018, pika a.ku jepet riformulimi i pikës 6 të Udhëzimit 29 lejohet të mbahen deri në 3 (tre) lëndë në semestër. Ky kriter plotësohet.</p> <p>Ka pedagogë që kanë ngarkesë më shumë se: ngarkesa në funksion titull/gradë + 200 orë suplementare në auditor.</p>	Kualifikimi	2017-2018		2018-2019		2019-2020		2020-2021		Në proces rekrutimi	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof	-	1	-	-	-	-	-	-		Prof As	1	-	1	-	1	-	1			Dr.PhD	6	-	7	-	6	-	8			Msc	11	-	9	2	12	2	8			Totale	18	1	17	2	19	2	17	-	
Kualifikimi	2017-2018		2018-2019		2019-2020		2020-2021		Në proces rekrutimi																																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																													
Prof	-	1	-	-	-	-	-	-																																																													
Prof As	1	-	1	-	1	-	1																																																														
Dr.PhD	6	-	7	-	6	-	8																																																														
Msc	11	-	9	2	12	2	8																																																														
Totale	18	1	17	2	19	2	17	-																																																													

	<p>Kriteri në lidhje numri i lëndëve që mund të mbajë një pedagog i brendshëm plotësohet ndërsa në lidhje me ngarkesën mësimore nuk plotësohet.</p> <p>Evidencë RVB, tabela 4.</p>				
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik PAE dhe PAK i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në inxhinieri Elektrike ka kualifikimin e duhur.</p> <p>Drejtuesja e DIDT, zotëron titullin akademik “Prof. Asoc” në përputhje të plotë me kërkesat e LAL 80/2015, neni 42, pika 3.</p> <p>DIDT është i përbërë nga dy grupe mësimore/kërkimore ku drejtues i grupit mësimor/kërkimor elektrik është Inxhinier Elektrik.</p>				
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>PAE dhe PAK të angazhuar në këtë program studimi kanë kualifikimin e duhur për këtë program studimi.</p> <p>Fusha akademik e PAE dhe PAK që japin lëndët karakterizuese të programit të studimit, janë:</p> <p>PAE: dy inxhinierë elektrike, një është inxhinieri elektronike një është inxhinieri ndërtimi, një është inxhinier mekanik.</p> <p>PAK: një është inxhinier elektrik; një është inxhinieri elektronike.</p> <p>Kualifikimi i stafit akademik që vjen nga departamentet e tjera të FSHTN është në përputhje me natyrën dhe specifikën e lëndës, që mbulojnë.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UV ka bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, <u>evidencë I.10</u>, që u shërben programeve të tjera Bachelor që mbështet FSHTN, por jo këtë program studimi.</p> <p>UV ka bashkëpunim me kompani e biznese të ndryshme por vetëm dy marrëveshje janë në mbështetje të këtij programi studimi, ajo me Tec Vlora dhe me drejtorinë rajonale OST, Fier, <u>evidencë I.17 dhe I.18</u>.</p> <p>GVJ sugjeron që UV të ketë Marrëveshje bashkëpunimi edhe me Universitetin Politeknik të Tiranës, që ofron programe studimi të fushave inxhinierike në të tre ciklet e studimit.</p> <p>Personeli i vënë në dispozicion për realizimin e praktikës mësimore është i pamjaftueshëm, vetëm 1 PAE, inxhinieri elektrike, e cila ka kualifikimin e duhur për realizimin e praktikës mësimore.</p> <p>Me riorganizimin e programit të studimit, detyrimi përmbyllës është provimi përfundimtar, <u>evidencë III.22</u>.</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Për personelin ndihmës akademik, mungon informacioni mbi arsimin e tij dhe shkallën e kualifikimit prandaj nuk gjykojmë dot nëse është personel i përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratoreve dhe mjediseve të tjera specifike, <u>evidencë II.11</u>.</p>				
	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përbushet pjesërisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit			X	
--	--	--	----------	--

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët, u evidentua se institucioni angazhohet vazhdimisht për njohjen e problematikës së shprehur në aspektet e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Kjo realizohet përmes pyetësorëve që zhvillohen sistematikisht, ku theksi vihet tek mësimdhënia dhe performanca e stafit akademik.</p> <p>U pohua gjithashtu se në nivel institucioni është hartuar një udhëzim në lidhje me zhvillimin dhe përdorimin e formave e metodave inovative të mësimdhënies në përputhje me karakterin e lëndëve, por në dosjen e akreditimit ky dokument mungon.</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	<p>UV ndjek politika dhe ka hartuar procedura për monitorimin dhe vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Kjo mundësohet përmes mekanizmave në nivel institucioni dhe nivel departamenti e programi studimi.</p> <p>Prej 2 vjetësh NJVSBC është riorganizuar në nivel institucioni dhe monitoron indikatorët që tregojnë performancën e stafit akademik dhe ndihmës akademik në fushat: mësimdhënie, kërkim shkencor, mbështetja ndaj institucionit, vlerësimi nga studentët, me qëllim arritjen e standardeve shtetërore të cilësisë në arsimin e lartë. UV me vendime të Senatit Akademik ka miratuar përmirësime të vazhdueshme të pyetësorëve të cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së shërbimeve administrative që organizohen 2 herë në vit.</p>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	<p>UV përveç vlerësimit periodik që kryen përgjegjësi i njësisë bazë për stafin akademik e ndihmës akademik që ka në varësi, përfshin edhe studentët në mënyrë masive për vlerësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe shërbimeve administrative.</p> <p>Studentët plotësojnë një pyetësor 2 herë në vit, ku ata mund të evidentojnë problematikën në çdo lëndë duke krijuar mundësinë për stafin akademik që të bëjë përmirësimet e nevojshme apo të hartojë startegji për ndryshime afatmesme.</p>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë	NjVSBC e UV që monitoron sigurimin e cilësisë në mësimdhënie në nivel institucioni, harton raporte në lidhje me rezultatet e vlerësimit

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 2019, Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 26

në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	marrë prej pyetësorëve, nxjerr përfundimet në nivel programi studimi dhe ia vë në dispozicion departamentit që mbulon programin e studimit.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	NjVSBC në UV publikon në faqen zyrtare të UV raportin me rezultatet e pyetësorëve të studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe problematikat me stafin akademik e ndihmës akademik. Kjo praktikë promovon shembujt e mirë dhe inkurojon stafin akademik drejt rritjes së vazhdueshme të nivelit të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Mbështetur në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi, vihet re se lëndët e formimit profesional realizojnë transmetimin e dijeve nëpërmjet formave të ndryshme të mësimdhënies si: leksione, seminare, laboratore, detyra kursi. Secila nga këto veprimtari mësimore ka peshën e vet vlerësuar me kredite, konform sistemit të Bolonjës për vlerësimin dhe transferimin e krediteve. Për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksionet: 103.2 kredite - Seminarët: 60 kredite - Punët laboratorike: 10.8 kredite - Praktika mësimore: 6 kredite - Teza e diplomës: 6 kredite <p>Praktika mësimore zhvillohet si lëndë e veçantë ku një ditë e javës i dedikohet kësaj lënde. Këto forma mësimdhënie janë të miratuara nga institucioni dhe pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit.</p>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	<p>Personeli akademik i programit të studimit, në mbështetje dhe plotësim të kërkesave të studentëve, evidentuar nga rezultatet e pyetësorëve që kryen institucioni, përpiket që për lëndët formuese profesionale të përdorë forma e metoda të ndryshme mësimdhënieje, duke gërshetuar punën në auditor me praktikën inxhinierike.</p> <p>Nisur nga karakteri i theksuar profesional e aplikativ i këtij programi studimi, personeli akademik ka bërë përpjekje që të mbështesë nevojat e studentëve me veprimtari mësimore praktike përmes eskursioneve mësimore në subjektet shtetërore apo private në rrethin e Vlorës që administrojnë dhe mirëmbajnë rrjetat e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, ndërmarrje industriale etj. Këto veprimtari kryhen në përshtatje me natyrën e programit të studimit dhe në përputhje me llojin e lëndëve mësimore dhe kohën e kryerjes së tyre. Këto forma mësimdhënieje përdoren në lëndë që nuk mund të kenë laboratore në UV, pra përdoren si mënyra plotësuese për rritjen e të nxënit nga ana e studentëve.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>DITD mbështet stafin akademik në përpjekjet e tij për përmirësimin e kompetencave didaktike. Sipas <u>evidences I.11</u>, gjatë viteve akademike 2017-2020, ka 21 mobilitete në të dy drejtimet, me aktivitet trajnimi apo mësimdhënie me 5 universitete europiane. Këto mobilitete janë kryesisht në mbështetje të programeve të tjera të studimit që mbulon DITD, pasi vetëm 1 staf akademik i programit të studimit “Bachelor në inxhinieri elektrike” ka qenë pjesë e këtyre aktiviteteve me këmbim eskperience. Pedagogë nga këto universitete kanë qenë pjesë në veprimtari trajnuese në DITD duke shkëmbyer eksperiencat e mira për metodat bashkëkohore të mësimdhënies në degët me karakter inxhinierik.</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i DITD që mbështet programin e studimit, është pothuajse staf akademik efektiv (ka vetëm 1 pedagog të ftuar), ku 50% e tyre janë me tituj e grada. Mbështetur në <u>Evidencën II.11</u>, ku tregohen CV e stafit akademik të programit të studimit, vihet re se angazhimi i personelit akademik në mësimdhënie është bërë konform fushave të tyre të studimit dhe fushave përkatëse të ekspertizës. Duke iu referuar edhe rezultateve të pyetësorëve të studentëve, është e qartë që personeli akademik i programit të studimit vlerësohet me kompetenca të mira në aspektin e mësimdhënies duke konfirmuar edhe përdorim të formave alternative të mësimdhënies.</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në UV, sondazhet e kryera tek studentët 2 herë gjatë vitit akademik përmes pyetësorëve për procesin mësimor, japin indikatorë në lidhje me performancën e personelit akademik në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këto rezultate përpunohen nga NJSBCVI dhe iu referohen departamenteve përkatëse. Më pas këto rezultate diskutohen në departamente dhe personeli akademik njihet me perceptimin dhe kërkesat që kanë studentët për seicilën lëndë. Kjo është një fillësë që personeli akademik vit pas viti të përmirësojë punën e tij për mësimdhënie sa më efektive. Kjo ndihmohet edhe prej rubrikave të hapura të pyetësorit ku studentët bëjnë komente e rekomandime në lidhje me procesin mësimor.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga ana e personelit akademik ka përpjekje që të përdorë metoda interaktive të mësimdhënies duke nxitur diskutimin e mendimin kritik në orët e mësimit, megjithëse duke iu referuar rezultateve të pyetësorëve të studentëve, kjo përpjekje duhet të vazhdojë sepse ka ende vend për përmirësim.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga <u>Evidenca I.6</u> Syllabuset e lëndëve, vihet re se lëndët e formimit profesional kanë në përmbajtje detyra kursi e laboratore, që janë nga format e mësimdhënies që e nxisin punën e pavarur të studentit. Gjatë kryerjes së laboratorëve apo detyrave të kursit pedagogët kanë mundësi të udhëzojnë studentët drejt rezultateve të pritshme të studimit, t’u sugjerojnë atyre raste studimore të reja, duke rritur vlerësimin dhe respektin e ndërsjellë midis tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Teknike ka në përdorim godinën C, ku sipas <u>Evidencës III.12 Infrastruktura e godinës C</u>, në total ka 3800 m² sipërfaqe në aula, laboratore, zyra, nyje hidrosanitare, ambiente shërbimi etj. Programi i studimit “Bachelor në inxhinieri elektrike” me rreth 120 studentë në të tre vitet e studimit, organizohet në grupe leksionesh me deri 60 studentë dhe grupe seminaresh 25-27 studentë.</p> <p>Mësimi zhvillohet paradite dhe ambientet rezultojnë të mjaftueshme për kapacitetet aktuale. Godina është rikonstruktuar vazhdimisht dhe ambientet janë me dritë, me hapësirë dhe mirëmbahen nga personeli sanitar.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Në katin e 3-të të godinës C janë kryesisht ambientet e dedikuara për këtë program studimi, si aulat, laboratorët etj. Klasat e mësimit kanë logjistikën e nevojshme për realizimin e mësimit me cilësi, pasi kanë të instaluar projektorët, tabelat, energji elektrike, etj. Laboratorët e informatikës janë klasa me kompjutera (kanë rreth 14 PC seicila) me softë inxhinierike në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Në mbështetje të programit të studimit është edhe laboratori i Elektroteknikës dhe Matjeve elektrike që është në shërbim të lëndëve profesionale inxhinierike. Nga ana e institucionit duhet të bëhen përpjekje për rritjen e ambienteve laboratorike dhe llojshmërisë së tyre, pasi ka një numër lëndësh si: Makina elektrike, Transmisione elektrike, Elektronikë fuqie etj, që nuk kanë laboratore të dedikuara.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Në ndihmë të personelit akademik dhe studentëve, UV ka në përdorim platformën digjitale të menaxhimit UVMS, përmes së cilës ata marrin informacione që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe rezultatet e arritura prej tyre. Nga ana tjetër në ambientet e godinës C: klasa, laboratore e biblioteka ka mundësi të vazhdueshme aksesit në internet përmes linjave kabllore dhe wi-fi.</p> <p>Studentët e pedagogët mund të komunikojnë edhe përmes adresave zyrtare të tyre që UV ka konfiguruar në formën emër.mbiemër@univlora.edu.al</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në syllabuset e lëndëve të programit mësimor ka të specifikuar literaturë bazë në gjuhën shqipe (tekste mësimore) dhe literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht, e cila miratohet prej DITD. Kjo literaturë ndodhet në bibliotekën e UV. Materiali mësimor që marrin studentët janë edhe leksione të shkruara prej pedagogëve, në formë fizike apo elektronike, me njohuri të përditësuara për lëndë të veçanta. Studentët shprehen se literatura është e mjaftueshme për kërkesat e tyre.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>UV ka në ambientet e saj 3 Biblioteka me salla leximi (120 vende gjithsej), ku njëra prej tyre ndodhet në godinën C dhe është e dedikuar për Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, me 23 vende. Personeli akademik dhe studentët e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” mund të aksesojnë ambientet e bibliotekës qendrore dhe bibliotekës së FSHTN. Sipas <u>Evidencës III.14</u>, koeficienti i shfrytëzimit të sallave të leximit llogaritet rreth 67%, pra kapacitetet e bibliotekave aktuale janë të mjaftueshme për personelin akademik dhe studentët. Ambientet e bibliotekave janë komode, me hapësirë, dritë dhe shërbim nga personel ndihmës akademik i dedikuar.</p>

	<p>Këto biblioteka kanë rreth 40 tituj të dedikuar për këtë program studimi në shqip dhe gjuhë të huaj. Me gjithë përpjekjet për pasurimin e fondit të bibliotekës, DITD duhet të rrisë numrin e titujve me botime bashkëkohore teknike të inxhinierisë elektrike , dedikuar programit të studimit “Bachelor në inxhinieri Elektrike”, pasi kjo do ndihmonte në rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe nivelin profesional të diplomave të studentëve.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Për të zgjeruar gamën e titujve në dispozicion të studentëve, UV ka në përdorim bibliotekën online, që aksesohet nga stafi dhe studentët në ambientet e bibliotekave. Në faqen zyrtare të UV ka edhe një manual shpjegues se si mund të aksesohet biblioteka online nga personeli akademik e studentët. Biblioteka online iu shërben studentëve dhe stafit akademik të gjejnë literaturë në fushat e tyre të studimit dhe në fushat e përafërta me to, në mbështetje të procesit të mësimdhënies, mësimnxënies, temave studimore të diplomave, kërkimit shkencor etj.</p> <p>Një përpjekje e mirë në ndihmë të mësimdhënies është edhe digjitalizimi e katalogimi i fondit aktual të bibliotekës së UV, me qëllim përdorimin sa më eficient të saj prej stafit e studentëve.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga ana e institucionit janë krijuar kushte të përshtatshme që studentët e programit të studimit, përveç mësimin, të kenë mundësi të kryejnë punën përgatitore për laboratorët, detyrat e kursit apo punimet e diplomës.</p> <p>Në godinën C, kati III, DITD ka ngritur 1 laborator me hapësira të mjaftueshme: Elektroteknika dhe Matjet Elektrike, dhe 2 laboratore informatike, pajisur me kompjutera ku janë instaluar software në ndihmë të studentëve për të kryer punimet e tyre në mënyrë të pavarur. Përveç këtyre laboratoreve, në dispozicion të studentëve janë edhe ambientet e dy bibliotekave, në godinën A dhe C, ku përveç ambienteve komode, studentët mund të aksesojnë edhe literaturën e nevojshme. Këto ambiente kanë edhe wi-fi falas.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Situata e pazakontë e krijuar prej pandemisë së COVID 19, detyroi personelin akademik të UV që të përdorë platformën UVMS për të zhvilluar mësimin online për lëndët e programit mësimor të semestrit të dytë për vitin akademik 2019-2020 dhe semestrin e parë të vitit akademik 2020-2021.</p> <p>Përdorimi i kësaj platforme ka mundësuar ngarkimin prej pedagogëve të lëndëve të materialeve didaktike si leksione, seminare, laboratore virtuale në formate pdf, pptx, etj. Gjithashtu janë përdorur edhe komunikimet në kohë reale midis studentëve e pedagogëve përmes Google Classroom, Zoom etj, për diskutimin e çështjeve të caktuara mësimore.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>UV ka në shfrytëzim sistemin e komunikimit të brendshëm bazuar në platformën UVMS, ku personeli akademik dhe studentët kanë hapësirën e tyre të dedikuar dhe iu mundësohen atyre një sërë shërbimesh për tërheqje dokumentacioni elektronik prej sekretarisë mësimore ose zyrës së financës, nëpërmjet adresës elektronike personale zyrtare.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Me vendim të Senatit Akademik, studentët që kanë të drejtë të përmbyllin ciklin e parë të studimeve me mbrojtje diplome, duhet të kenë mesatare mbi 9. Ky kufizim bëhet me qëllim fokusimin tek studentët me pritshmëri më të mirë në aspektin e kërkimit shkencor. Këta studentë orientohen dhe mbështeteten në punën e tyre të pavarur nga personeli akademik. Nga ana e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 2019, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 30

	UV bëhen përpjekje për krijimin e një database për punimet e diplomave të studentëve.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UV ka prej 2016 Njësinë e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë e Vlerësimit Institucional, të riorganizuar në 2018. Kjo strukturë vepron në nivel institucional dhe monitoron treguesit e cilësisë përmes pyetësorëve, promovon përmirësimin e mësimdhënies duke bashkërenduar me njësitë bazë pas përpunimit të rezultateve e hartimit të raporteve.</p> <p>Një strukturë tjetër Brenda UV është edhe Qendra e Zhvillimit Rajonal, që organizon kurse kualifikimi e trajnime të ndryshme, një ndër të cilët ka lidhje të drejtpërdrejtë me mësimdhënien.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas Statutit të UV, njësia kryesore dhe njësia bazë janë përgjegjëse për cilësinë e programit të studimit që ofrojnë, përgjegjësi që reflektohet tek rishikimi i vazhdueshëm i programit mësimor dhe syllabuseve, monitorimi dhe përmirësimi i procesit të mësimdhënies, rekrutim i kujdesshëm i stafit akademik në përputhje me kërkesat e programit të studimit etj.</p> <p>Nga ana e FSHTN dhe DITD vërehet se këto tregues ndiqen me kujdes në përbushje të misionit të UV. Nga ana tjetër, përfshirja e stafit dhe studentëve në diskutimet për rregulloret, buxhetin, pyetësorët, përmirësimet e pyetësorëve, sondazhin kombëtar të studentëve etj, bëjnë që vetëdija e tyre për cilësinë e produktit të UV të rritet.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>UV ka ngritur Brenda vetes një strukturë me emërtimin Qendra Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal (RDC), e cila në një nga aktivitetet e saj ka trajnime në lidhje me mësimdhënien. Kjo qendër eksperimenton dhe promovon metoda inovative të mësimdhënies jo vetëm për UV por edhe për mësues në qarkun e Vlorës.</p> <p>Në përbushje të planit strategjik 2018-2024, RDC hartoi edhe Udhëzuesin në lidhje me këtë çështje, por ky dokument nuk gjendet në dosjen e akreditimit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>UV e mbështet stafin akademik në drejtim të kualifikimit të vazhdueshëm dhe kërkim shkencor, pasi është një nga faktorët më kryesorë në përmirësimin e mësimdhënies. Kjo mbështetje është jo vetëm institucionale e logjistike, por edhe financiare. Kjo verifikohet përmes Evidencës III.6.</p> <p>Vihet re se numri i stafit akademik prej DITD dhe programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” të përfshirë në pjesmarrje konferencash e botime është relativisht i ulët, prandaj duhet që njësia bazë të nxisë stafin drejt përfshirjes më intensive në kërkim shkencor.</p>

Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Në UV mungon marrja e trajnimeve të personelit akademik prej strukturave të brendshme të UV në drejtim të mësimdhënies, por personeli akademik nxitet të përfshihet në projekte ndërkombëtare e kombëtare për mobilitet stafi me qëllim implementimin e metodave të reja në mësimdhënie.			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Sipas Udhëzuesit të miratuar në lidhje me metodat e mësimdhënies, DITD përpiqet të trajnojë edhe personelin ndihmës akademik në lidhje me mësimdhënien e metodat e reja të saj, në zbatim të programit të studimit.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Në dosjen e akreditimit nuk ka raportim zyrtar në lidhje me analizën e efektshmërisë së metodave të reja të mësimdhënies, por në takimin me stafin akademik u pranua që diskutimet midis kolegësh dhe me studentët në lidhje me këtë çështje, bëhen herë pas here.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Bazuar në Evidencat 1.2, 1.3, 1.9, në rregulloren e DITD e rregulloren e programit të studimit përcaktohen kriteret e mënyrat e vlerësimit të njohurive e aftësive profesionale. Kjo iu bëhet me dije studentëve që në hyrjen e tyre në UV, dhe gjithashtu informohen se këto rregullore dhe jo vetëm, mund t'i konsultojnë në faqen zyrtare të UV.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimet me studentët, u konfirmua se informimi e studentëve për metodologjinë e testimit e vlerësimit të dijeve bëhet edhe nga secili pedagog në fillim të lëndës. Pedagogu informon në lidhje me detyrimet, mënyrën e shlyerjes së tyre, afatet e shlyerjes, dhe mënyrën e kryerjes së provimit përfundimtar. Këto forma vlerësimi parashikohen edhe në syllabuset e lëndëve të programit mësimor.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në syllabuset e lëndëve dhe nga informacioni i marrë prej stafit akademik dhe studentëve, rezulton se testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme, gjatë gjithë semestrit, duke iu referuar performances së tyre në kryerjen e laboratoreve, detyrave të kursit, pjesmarrjes në seminare dhe pjesërisht edhe në kolokiumet (provimet e ndërmjetme). Kjo jep mundësi që student të jetë i përfshirë në studimin e lëndës vazhdimisht dhe të demonstrojë në vazhdimësi ecurinë e kompetencave të fituara nga zhvillimi i lëndës.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm</p> <ul style="list-style-type: none"> • Provimi përfundimtar (55-65%) e vlerësimit të përgjithshëm, • Provimi i ndërmjetëm (25-30%) e vlerësimit të përgjithshëm, • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, punë laboratorike, detyra/projekte kursi (10-15%) e vlerësimit të përgjithshëm. <p>Sipas rregullores së programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” testimi i njohurive e vlerësimi final i studentëve bëhet në 3 sesione. Shtohen në këtë proces edhe provimet e ndërmjetme në lëndët që e parashikojnë në syllabus. Gjithashtu sipas rregullores, ka kufizim të numrit të lëndëve që mund të përmirësohen (4 lëndë për gjithë periudhën e studimit dhe jo më shumë se 2 lëndë gjatë 1 viti akademik).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UV ka në përdorim platformën digjitale të menaxhimit UVMS, i cili ndihmon stafin akademik, sekretarinë mësimore dhe studentët të marrë informacionin e duhur në kohë minimale e pa burokraci. Institucioni nuk ka në zbatim sistem elektronik të testimit e vlerësimit që kanë potencial të lartë në lidhje me eliminimin e formave të ndryshme të abizimit dhe në rritjen e transparencës së vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Praktika e punës së DITD për testimin e vlerësimin e studentëve bazohet tek komisionet e pedagogëve që kanë zhvilluar lëndën, por të drejtën e firmës në fletën e provimit e ka vetëm pedagogu që ka zhvilluar leksionet.</p> <p>Kur lënda zhvillohet nga 1 pedagog i vetëm, ai është anëtar i vetëm i komisionit të vlerësimit.</p> <p>Për provimin e diplomës komisioni ka 5 anëtarë nga pedagogët e programit të studimit. Kjo procedurë vlerësimi me komisione me 1 anëtar, mund të gjenerojë problematikë në lidhje me objektivitetin e vlerësimit, kështu që duhet të shikohet mundësia prej DITD që të rishikohet.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në UV testimi i njohurive bëhet me shkrim, gojë dhe i kombinuar. Në rastin e provimit me shkrim, procedohet pa sekretim ose kodifikim. Departamenti merr masa që procesi i testimit të kryhet konform rregullores, duke siguruar ambientet dhe personelin monitorues, por jo mjete survejimi, sipas numrit të studentëve pjesëmarrës. Titullari i lëndës ose pedagogu që ka kryer leksionin mban përgjegjësi për vlerësimin e studentëve dhe vendosjen e rezultateve në afatin e përcaktuar në UVMS.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback,</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit dhe e DITD specifikon se procesi i vlerësimit bëhet brenda 48 orëve, dhe më pas rezultatet shpallen në UVMS.</p>

i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studentët që duan transparencë për vlerësimin e bërë, kanë të drejtë të shikojnë provimin e tyre të korigjuar bashkë me komente të pedagogut, në ndihmë të studentit të përmirësojë procesin e të nxënit në të ardhmen.			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Në Kodin e Etikës së UV dhe rregulloren e programit të studimit, njësia bazë dhe personeli akademik përpiqen të shmangin plagjiaturën në detyrat e kursit e temat e diplomave si dhe kopjen në provime. Pedagogu ka të drejtë të ndëshkojë studentin që merr ose jep kopje (përmes telefonit ose librave, fletoreve të lëndës etj.), duke i ulur pikë në provim ose duke e përjashtuar nga provimi me vlerësim negativ.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga DITD në UV ka kujdes të veçantë në zbatimin e procedurave të vlerësimit të studentëve mbi bazën e meritës dhe brenda afateve që përcaktohen në rregullore. Nga ana e studentëve nuk rezulton të ketë ankesa në lidhje me këtë proces.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Pavarësisht se personeli akademik përpiqet që procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive të bëhet sipas rregulloreve, nga ana e institucionit, studentëve iu njihet e drejta për transparencë të plotë në procesin e korigjimit e vlerësimit të marrë. Në tezë ata njihen edhe me skemën e vlerësimit dhe numrin e pikëve që mund të fitojnë nga zgjidhja e saktë e çdo ushtrimi.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Në rregulloren e DITD dhe programit të studimit parashihet edhe procedura që ndiqet në rastin kur ankesa e një studenti mbetet e pazgjidhur me pedagogun e lëndës. Në këtë rast, DITD e përcjell ankesën e studentit tek Dekani. Brenda 48 orëve ngrihet një komision ad-hoc prej dekanit dhe bën vlerësimin përfundimtar të provimit. Në lidhje me evidentimin e arkivimit e këtyre procedurave nuk ka dokumentacion, pasi sipas DITD nuk ka patur ankime në lidhje me vlerësimin nga ana e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” është konceptuar si një bashkësi dijesh në fushën e inxhinierisë elektrike, ku lëndët e programit mësimor kategorizohen në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018, “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”. Kuotimet e vendosura nga ky udhëzim, respektohen për të gjithë kategoritë. Lëndët bazë kanë 20% të programit mësimor dhe janë në mbështetje të lëndëve karakterizuese që zënë 53.33%. Programi mësimor plotësohet me lëndë ndërdisiplinore që zënë 13.33%, lëndë plotësuese 10% dhe detyrime përmbyllëse 3.33%.

	Lëndët karakterizuese që formojnë anën profesionale, janë përzgjedhur që mundësojnë njohuri teorike e praktike në lëmin e zbatimeve të inxhiniersë elektrike dhe krijon premisa për thellimin e njohurive në studimet në nivelin master ose në aktivitetin e tyre në tregun e punës.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Përfshirja e lëndëve karakterizuese dhe me karakter ndërdisiplinor e integrues mundëson zhvillimin e aftësive në drejtim të zbatimeve të thjeshta industriale, energjive të rinovueshme, standardet etj. Krijimi i aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit do të kërkonte ndryshime thelbësore në kurrikul.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Sipas takimeve me stafin e studentët, zhvillohen diskutime dhe analizohen kompetencat që fitojnë studentët nga secila lëndë, por për këtë çështje nuk ka evidencë.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Takimi me studentët dhe pedagogët konfirmoi se në përgjithësi, në fund të lëndës, pedagogët zhvillojnë seanca konsultimi me klasën në lidhje me evidentimin e çështjeve më të rëndësishme të lëndës dhe orientojnë studentët në përgatitjen për provim apo implementimin e tyre në praktikë.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga ana DITD në bashkëpunim me Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve njerëzore, është organizuar orë e hapur mësimore me lektor të huaj, që zhvilloi leksion mbi zhvillimet e reja në fushën e energjive të rinovueshme, në qershor 2019, Evidenca III.20. Nuk ka evidence të orëve të hapura zhvilluara prej personelit akademik të UV DITD.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	DITD ka ngritur një laborator për Elektroteknikën dhe Matjet elektrike, ndërsa për lëndë të tjera si Makinat Elektrike, Transmisionet elektrike, Shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike, në FSHTN nuk ka laborator. Laboratorët e këtyre lëndëve zhvillohen nëpërmjet eskursioneve mësimore. Për zhvillim më të mirë të kompetencave profesionale, DITD duhet të gjejë mjetet e nevojshme dhe burimet e financimit për ngritjen dhe plotësimin gradual me laboratorë për të gjithë lëndët profesionale.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Takimi me studentët tregoi se pedagogët zhvillojnë diskutime dhe organizojnë punë në grup për studentët në kryerjen e detyrave të kursit apo zgjidhjen e problemeve të caktuara nga fusha e studimit të lëndëve konkrete.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Pedagogët krijojnë ambient të përshtatshëm jo vetëm për diskutimin e çështjeve të caktuara teknike, por edhe në zhvillimin e ideve inovative që studentët mund të marrin si nxitje nga praktikat profesionale në grup apo individuale. Studentët mbështeten me literature shtesë apo referenca teknike për studim të pavarur.
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	UV ka marrëveshje bashkëpunimi për mobilitet studentësh me disa universitete dhe ka konkretizuar 5 mobilitete studentësh nga programi i studimit “Bachelor në inxhinieri elektrike”, të cilat janë kryesisht për studime në Universitete në: Turqi, Greqi, Poloni, Letoni. Këto mobilitete mbështetin studimet e avancuara kërkimore e shkencore të cilat mbështeten edhe financiarisht. Kjo vërtetohet me Evidencën I.12.

	Gjithashtu, një formë e mbështetjes finaciare është pjesmarrja e studentëve në konferenca pa pagesë.		
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik në UV DITD priret të unifikojë metodat e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese jashtë vendit me qëllim që të mundësojë mobilitet studentësh. Gjatë viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 janë realizuar 8 mobilitete studentësh nga DITD, 5 prej të cilëve janë nga programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”, gjë që tregon një ecuri të mirë në këtë drejtim.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	DITD ka procedure diplomimi për studentët e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”, e cila shpjegohet në rregulloren e programit të studimit dhe të DITD. Këto rregullore gjenden në faqen web të UV dhe studentët kanë dijeni për këtë. Diplomimi i studentëve bëhet me provim final ose me temë diplome, gjë që përcaktohet në rregullore bazuar mbi notën mesatare. Rregullorja përcakton kohën e aplikimit dhe kufirin minimal të krediteve të fituara që duhet të ketë studenti për të fituar të drejtën e aplikimit për diplomim në sekretarinë mësimore.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Pedagogët e DITD që mbulojnë programin e studimit dhe stafi i sekretarisë mësimore informojnë studentët dhe iu vënë në dispozicion material për provimin final të diplomimit apo për temat e diplomave. Provimi final i diplomimit bazohet tek lëndët karakterizuese, sipas peshës në kredite që ato kanë në planin mësimor.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	DITD ngre komision të posaçëm për provimin e diplomimit, i cili mund të zhvillohet si provim me shkrim ose si mbrojtje e nje teme diplome. Në rastin e provimit me shkrim, testimi përmban njohuri nga lëndët karakterizuese të zhvilluara gjatë 3 viteve të studimit dhe pasha e tyre në provim është në përputhje me peshën që ka lënda përkatëse në planin mësimor.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Për temat që trajtohen në provimin final të diplomimit, studentët njihen nëpërmjet udhëzimeve që marrin prej pedagogëve 3 muaj para provimit. Për studentët që përgatiten për provimin final, pedagogët organizojnë edhe konsultime. Studentët me mesetare mbi 9 fitojnë të drejtën e diplomimit me temë diplome. Edhe këta studentë marrin orientimet e nevojshme prej pedagogëve si në përzgjedhjen e temës ashtu edhe në zhvillimin e saj.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e	Studentët që punojnë për mbrojtjen e temës së diplomës, asistohen prej DITD duke iu vënë në dispozicion laboratorët apo bibliotekën e FSHTN si dhe ndihmën e subjekteve bashkëpunëtoare të saj për rastin kur objekti i

institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	temës së diplomës nuk mund të zhvillohet (matjet, analizat, testet) në ambientet e UV.			
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo një punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomës, bazuar në rregulloren e programit të studimit, asiston studentin diplomant në çdo hap të zhvillimit të saj, duke filluar me përzgjedhjen e literaturës, kontrollin e matjeve ose simulimeve, udhëzon për strukturën e shkrimit të tezës dhe saktësisinë e vlefshmërinë e rezultateve. Në fund të procesit të hartimit të tezës, ai shprehet me shkrim për cilësinë e punimit dhe aprovon paraqitjen e temës para komisionit të mbrojtjes së diplomave.			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi i studentit në provimin final të diplomimit apo mbrojtjen e temës së diplomimit bëhet me notë. Për rastin e provimit final, nota vendoset nga pikët e grumbulluara nga gjithë pedagogët e komisionit të provimit që vlerësojnë ushtrimet nga lëndët përkatëse. Në rastin e mbrojtjes së temës, nota vendoset nga mesatarja e notave që vendos secili prej anëtarëve të komisionit.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet financiare dhe kanë fituar 180 kredite, pajisen me diplomë dhe suplementin e diplomës që hartohen në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Përmbajtja dhe forma e Diplomës është në përputhje me udhëzimet e MASR.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit të studimeve, studentëve që paraqesi kërkesë në sekretarinë mësimore, iu vihet në dispozicion kundrejt pagesës : lista e notave, suplementi i diplomës dhe programi i plotë i studimeve. Tarifa e kësaj pagese përcaktohet me Vendim të Senatit Akademik të UV. Kjo kopje zyrtare i dorëzohet kërkuarit jo më vonë se 10 ditë nga kërkesa.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	UV ruan në sekretarinë mësimore këto të dhëna për studentët: a) Regjistrin themeltar me të dhënat personale b) Regjistrin e notave të marra gjatë programit të studimit c) Regjistrin e lëshimit të diplomave e çertifikatave. Këta regjistra janë sipas formateve të miratuara nga MASR. Këta regjistra ruhen për kohë të pacaktuar. Përveç tyre, sekretaria ruan edhe provimet e studentëve deri në fund të semestrit pasardhës. Temat e diplomave ruhen në Bibliotekë për një periudhë të pacaktuar. Nëse kërkohet, sekretaria mësimore i jep studentit informacion në lidhje me dokumentat që ka në ruajtje dhe i arkivon për periudhë të pacaktuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>UV ka ngritur një strukturë , Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arshivës si pjesë e Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore që ka përgjegjësi mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave për personelin akademik ,ndihmës akademik dhe administrativ. Kjo strukturë vepron në nivel institucioni. Nga takimi me anëtarët e këtij sektori dhe verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit që kjo drejtori ka në administrim, u vu re se dokumentacioni për stafin akademik të rekrutuar bëhet konform ligjit. Në dosjen individuale të personelit akademik, përveç dokumentacionit të dorëzuar në pranimin e tij në institucion, janë edhe kontratat e punës me afat 1vjeçar për personelin pa gradën shkencore “Doktor”. Personeli akademik me gradën shkencore “Doktor” e sipër ka kontratë pa afat.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga verifikimi i procedurave të punësimit për personelin akademik në UV, del e qartë se Drejtorja e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore zbaton procedura që parashikohen në Rregulloren e UV dhe në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Procedura fillon me marrjen e kërkesës prej departamentit që ka vend vakant (kërkesa i drejtohet Rektorit të UV), shoqëruar me kriteret e përzgjedhjes dhe pranimit së kandidatit dhe grupin e lëndëve që ka interes DITD. Vendi vakant shpallet në faqen web të UV sëbashku me kriteret e përzgjedhjes së kandidatit. Më pas me konkuresit që kanë dorëzuar dosjen personale me dokumentacionin e kërkuar, zhvillohet një intervistë me komisionin e vlerësimit, i cili më pas merr vendimin. Nga ana e DKBNj bëhet njoftimi përfundimtar për rezultatin e konkursit tek kandidatët pjesëmarrës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p><u>Aktet e brendshme rregullatore të UV</u> kanë të shprehura procedurat dhe kriteret e përgjithshme për rekrutimin e personelit akademik.</p> <p>Kriteret specifike të rekrutimit shprehen prej njësisë bazë në përputhje me nevojat që ka. Këto kritere specifike i bëhen me dije Drejtorisë së Komunikimit e Burimeve Njerëzore dhe kjo e fundit i bën publike në njoftimin e bërë në faqen web të UV.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e ndjekura nga strukturat e UV për rekrutimin e personelit akademik vlerësojnë kandidatët e interesuar mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike, të cilat publikohen dhe synojnë të përzgjedhin personel akademik me kualifikimin e duhur dhe në përputhje me natyrën e përmbajtjen e programit të studimit. Nga ana e DITD u shpreh shqetësimi se rekrutimi i personelit akademik me grada shkencore është shumë i vështirë edhe për shkak të mosfunksionimit të shkollave të doktoratës prej disa vitesh.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>UV ka vendosur në dispozicion të FSHT godinën C, në katin e parë të së cilës ndodhet edhe biblioteka e FSHT me sipërfaqe 80 m². Ambientet e tjera të godinës 4 katëshe janë auditore, laboratore e zyra për studentët e stafin akademik e ndihmës akademik të fakultetit.</p> <p>Ambientet janë të mirëmbajtura, me dritë, dhe të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin e mësimi. DITD ka në dispozicion 2 zyra për stafin akademik, 2 laboratore, nga të cilat vetëm një është i dedikuar për studentët e programit të studimit në Bachelor i Inxhinierisë Elektrike.</p> <p>Numri i klasave për zhvillimin e mësimi jepet në total për të gjithë FSHT, dhe shpërndarja bëhet sipas numrit të studentëve. Nga stafi u pranua që ambientet janë të mjaftueshme edhe për personelin akademik edhe për studentët duke patur parasysh prurjet e deritanishme.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>UV ka hartuar dy strategji për zhvillimin e ndërkombëtarizimin, me qëllim kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik dhe shkëmbim eksperiencash në mësimdhënie. Nga DITD gjatë vitit akademik 2019-2020 kanë fituar të drejtën e mësimdhënies 3 anëtarë të DITD që janë pjesë e mësimdhënësve në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike. Nga ana tjetër UV mbështet finaciarisht shpenzimet e stafit akademik për pjesëmarrjen e tyre në konferenca.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>UV bën përpjekje që të zbatojë metoda të reja bashkëkohore të mësimdhënies, në përshtatje me programin e studimit dhe në ndihmesë të rritjes së cilësisë. Sipas grupit të vlerësimit të brendshëm, është hartuar nga institucioni edhe një udhëzues për zhvillimin e mësimdhënies me metoda të reja dhe në përshtatje me fushat e studimit. Në mbështetje të këtyre metodave, UV ka ofruar logjistikën e nevojshme duke plotësuar klasat me vidioprojektorë, disa klasa janë me kompjutera etj. Klasat e auditorët janë të pajisura kryesisht me materialet e nevojshme për zhvillimin e mësimi në mënyrë tradicionale.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>UV ka staf akademik e ndihmës akademik angazhohen jo vetëm në zhvillimin e mësimi por edhe në kërkim shkencor dhe në mbështetje e studentëve për zgjidhjen e problemeve të tyre gjatë viteve të studimit në ciklin e parë. Nga ana e DITD janë marrë në punë personel akademik në përputhje me fushën e studimit dhe kërkimit shkencor të vlefshëm për programin e studimit. Vështirësia për ta qëndron në rekrutimin e stafit me kualifikime më të larta shkencore.</p> <p>Gjithsesi UV nxit stafin aktual dhe e mbështet në rritjen e tyre akademike. Ngarkesa mësimore e tyre është në përputhje me normativat në fuqi. Do të parapëlqejë zhvillimi i një numri më të vogël lëndësh për disa prej pedagogëve, të cilët zhvillojnë 4 lëndë semestrale, por kuptohet</p>

	vështirësia, pasi numri i studentëve në këtë program studimi nuk është i lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UV ka vënë në dispozicion të FSHT godinën C, ku 4 kate të saj përdoren për zhvillimin e mësimi (klasa, laboratore), ambiente të përbashkëta (koridore, biblioteka, nyje sanitare), ambiente zyrash për stafin etj. Sipas tabelës përmbledhëse ofruar nga UV, godina C, ka sipërfaqe totale 3800m² dhe ka një numër total prej 1694 studentësh që zhvillojnë mësimin në këtë godinë, për të gjitha programet e studimit që mbulohen nga FSHTN. Si rrjedhim, koeficienti i përdorimit të ambienteve të FSHTN prej studentëve të tij është $3800/1694 = 2.24 \text{ m}^2/\text{student}$. Bazuar në VKM 418 datë 10/05/2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • IAL me drejtim Shkencat e Natyrës ky koeficient është 2.5 • IAL me drejtim Inxhinieri e Teknologji, ky koeficient është 5. <p>Pra mund të themi se kapacitet e ambienteve të shfrytëzueshme për studentët janë shfrytëzuar plotësisht, madje janë në tejkalim.</p> <p>Ambientet e FSHTN kanë mungesë sigurimin e ajrit të kondicionuar dhe ngrohjes qëndrore. Kjo mangësi krijon problematikë për zhvillimin e mësimi në periudhën e verës dhe dimrit.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset e tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset e klasave, auditorëve, laboratorëve etj, ku zhvillohet mësimi, janë të pajisura pjesërisht me kompjutera. Përgjithësisht mësimi zhvillohet sipas mënyrës tradicionale dhe klasat janë të pajisura me infrastrukturën për këtë tipologji mësimdhënies. Gjithsesi, në laboratore e në bibliotekë, ambientet janë të pajisura me mjete didaktike e pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, si kompjutera, videoprojektorë etj.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>DITD ka në dispozicion të studentëve që studiojnë në programin “Bachelor në Inxhinieri elektrike” 2 laboratore, ku zhvillohen seancat laboratorike për lëndët: Elektroteknikë, Matje elektrike, Elektronikë analoge dhe Fizikë. Është e nevojshme që UV dhe FSHT të konsiderojë mundësinë e ngritjes së laboratoreve të reja për lëndë të karakterit profesional si: Makina elektrike, Transmisione elektrike, Elektronikë fuqie, rrjetat e shpërndarjes së energjisë elektrike.</p>

	Deri më tani labororet e këtyre lëndëve zhvillohen si eskursione mësimore, por kjo mënyrë nuk mund ta zëvendësojë efektin e kryerjes së laboratorit në auditor, edhe pse vlerësohet përpjekja e DITD për njohjen prej studentëve të aspekteve praktike në lidhje me fushën e studimit.								
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	FSHT në godinën C, ka një laborator informatike, që i shërben studentëve të gjithë programeve të studimit. Për studentët e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” nuk ka një laborator të dedikuar. Një laborator i tillë, i dedikuar, do të ishte i nevojshëm, pasi softet inxhinierike që do të duheshin për këtë program studimi janë specifike, që kërkojnë kompjutera me memorie e karta grafike cilësore e me kapacitete relativisht të larta. UV duhet të shohë mundësinë e krijimit të një laboratorit të tillë me qëllim zbutjen e mungesave të laboratoreve të: Makinave Elektrike, Transmisioneve elektrike, elektronikës së fuqisë etj, deri në momentin kur të gjenden burimet financiare për ngritjen e tyre.								
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Nga UV ka përpjekje që të krijojë mundësi bashkëpunimi me institucione e subjekte shtetërore e private me qëllim zhvillimin e praktikave mësimore e profesionale. Në dosjen e akreditimit ka një listë me institucione shtetërore e subjekte nga biznesi, por janë kryesisht për studentët e Inxhinierisë Navale. Nga ana e DITD është vendosur edhe një listë me biznese që UV ka marrëveshje për zhvillim praktikash, por nuk ka informacion të mjaftueshëm për vlerësimin e mbështetjes që ata mund të japin për studentët e “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	X								

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UV ka në ambientet e saj gjithsej 3 biblioteka. Në godinën C, ku DITD zhvillon aktivitetin akademik e mësimor, ka një bibliotekë me sipërfaqe 80m ² e 23 vende, e cila është në dispozicion të studentëve të FSHT. Nga ana tjetër, studentët e “bachelor në Inxhinieri Elektrike” mund të shfrytëzojnë edhe bibliotekën qendrore në godinën A (252 m ² e 60 vende), e cila është në shërbim të gjithë studentëve të UV. Sipas punonjësve të bibliotekës dhe studentëve, ambientet e bibliotekave kanë kapacitet të mjaftueshëm sepse kanë një koeficient shfrytëzimi (të llogaritur prej tyre) prej rreth 67%. Bibliotekat kanë kushte të mira, pajisur me literature, kompjutera dhe me orar të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për studentët. Biblioteka qendrore ka 2 punonjës shërbimi duke krijuar mundësi për kohë ditore më të gjatë shfrytëzimi prej studentëve.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo	Biblioteka e godinës C ka kryesisht tekste mësimore dhe literature ndihmëse në gjuhë shqip dhe të huaj, por ato konsiderohen të pamjaftueshme për studentët e programit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”. Fondi i saj nevojitet të pasurohet me tituj të rinj dhe revista

<p>revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>teknike bashkëkohore, me qëllim mbështetjen e studentëve në punën kërkimore për detyrat e kursit në lëndët e formimit profesional dhe diplomat. Biblioteka e godinës C është hapur në vitin 2018 prandaj ka nevojë të pasurohet me literature mbështetëse për studentët e inxhinierisë elektrike. Literatura e vlefshme për studentët e inxhinierisë elektrike në bibliotekën qendrore është relativisht e ulët me gjithë përpjekjet që UV bën për mirëmbajtjen e tyre.</p> <p>Në bibliotekën e FSHT ka gjithsej rreth 236 tituj, por titujt në dispozicion të studentëve të inxhinierisë elektrike nuk specifikohet dhe konsiderohet i pamjaftueshëm. Edhe literatura në bibliotekën qendrore ka rreth 10.830 tituj të trashëguar e nga pasurimi, por literatura e huaj në anglisht për Inxhinierinë Elektrike nuk i kalon 40 titujt.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga ana e UV është krijuar mundësia për të gjithë studentët, që të shfrytëzojnë bibliotekën on-line “ULIBRARY” në ambientet e bibliotekës së UV. Në faqen zyrtare të UV jepen edhe informacionet e nevojshme sëbashku me manualat e përdorimit për studentët dhe pedagogët. Kësaj i vjen në ndihmë edhe puna që bëhet për katalogimin digjital të bibliotekës në kuadër të projekteve europiane për rrjetin e bibliotekave universitare në vendin tonë.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion si dhe nga materialet në dosjen e akreditimit, u konstatua se në bibliotekat A e C ku marrin shërbim studentët e programit të studimit “Bachelor në inxhinieri Elektrike”, nuk ka pajisje me kompjutera e sallave të leximit apo softe kompjuterike të përshtatshme për shfrytëzimin e literaturës së huaj. Nga ana e UV po bëhen përpjekje për digjitalizimin e materialeve të bibliotekës dhe pajisjen e sallave të leximit me kompjutera dhe projektorë.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bibliotekën qendrore dhe atë të godinës C ka patur pasurime të vazhdueshme me tituj të rinj në gjuhën shqip dhe në gjuhë të huaj. Në bibliotekën e FSHT ka patur 2 pasurime të fondit me 236 tituj gjatë viteve 2016-2018. Pasurimi i fundit i kryer në bibliotekën e FSHT është ai i bërë për kërkesën e bërë në vitin akademik 2018-2019 dhe i realizuar në janar 2020 me një vlerë prej 80.000 lekësh. Vihet re se titujt prej këtij fondi pasurimi të dedukuara për inxhinierinë elektrike janë relativisht të ulëta. Për vitet akademike në vazhdim duhet që DITD t’i kushtojë vëmendje shtimit të literaturës së huaj, botime të viteve të fundit, me qëllim që studentët e inxhinierisë elektrike të marrin dije sa më të përditësuara.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Bibliotekat në UV funksionojnë me orare të përshtatshme për përdorimin e tyre prej studentëve. Biblioteka qendrore funksionon me 2 turne ndërsa dy bibliotekat e tjera funksionojnë me 1 turn. Shfrytëzimi i ambienteve të tyre prej studentëve është në nivel të përbalueshëm për kapacitetet egzistuese, madje një përllogaritje e punonjësve të bibliotekës konkludon një shfrytëzim rreth 67% e sallave të leximit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 2019, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

Faqe 42

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UV në mbështetje të ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015, mban në formë të shkruar 3 regjistra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Regjistrin themeltar të studentëve 2) Regjistrin e arritjeve akademike 3) Regjistrin e diplomimeve dhe çertifikatave të lëshuara prej UV. <p>Prej sekretarisë mësimore administrohen edhe</p> <ol style="list-style-type: none"> a. dosjet e regjistrimit të studentëve me dokumentacionin sipas kërkesave të MASR, b. dosjet me procesverbalet e vlerësimeve të studentëve sipas viteve akademike c. dosjet e transferimeve të studimeve dhe ç’regjistrimeve. <p>Krahas kësaj, me vendim Nr.101, 6/12/2017 të Senatit të UV, është krijuar sistemi modular UVMS, i cili u ofron përdoruesve disa shërbime si: e-learning (marrje materialesh prej pedagogëve), marrje faturash në formë elektronike, marrja e rezultateve të provimeve etj, përmes hapësirës së dedikuar që ka secili student në këtë platform.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohen informacionet dhe dokumentacioni përkatës që ka lidhje me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe për partnerët. Ky informacion administrohet prej drejtorive të UV, duke filluar prej rekrutimit të tyre, e në vazhdimësi, në ndjekje të progresit akademik të tyre. Për këtë angazhohen Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Sekretaria mësimore dhe Departamentet/dekanati.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit nuk siguron akses të dedikuar për informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët (marrje të tyre në formë automatike), por strukturat e ndryshme si : zyra e financës, sekretaria mësimore, zyra e burimeve njerëzore, departamentet etj, hartojnë informacione në formë tabelore ose shkresore dhe i ngarkojnë ato në UVMS që të jenë të aksesueshme për përdoruesit e interesuar.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi UVMS është me karakter modular dhe ka të integruar platformën e-learning, e cila mundëson komunikim interaktiv të studentëve e pedagogëve, për shkëmbim materialesh mësimore në format pdf, si dhe dorëzimin e detyrave të studentëve. Në faqen web të UV gjendet edhe manuali i përdorimit të kësaj platforme.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale</p>	<p>Ky sistem menaxhimi krijon mundësinë që personeli akademik e administrativ të monitorohen prej departamenteve në kohë reale dhe veç kësaj lejon marrjen e dhënien e raportimeve individuale ose mbi bazë njësie bazë për organet drejtuese e titullarët e tyre.</p>

dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.									
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare web të UV: https://univlora.edu.al , jepet informacion për programet e studimit që ofrohen, në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në këtë faqe ka informacion për fakultetet/programet e studimit, për projektet ku bën pjesë UV, legjislacioni: rregulloret, statuti etj, biblioteka on-line, studentët, kërkimi shkencor e publikimet e stafit akademik etj.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Në dosjen e akreditimit është depozituar një raport i detajuar financiar në lidhje me shpenzimet që UV bën për realizimin e misionit të saj. Këto shpenzime janë mbështetur në vendimet e Bordit të Administrimit të UV, të cilët gjenden edhe në faqen web të UV. Në formë tabelore tregohen:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) të ardhurat (nga MASR dhe nga tarifat e regjistrimit) 2) shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, bursat, shpenzime për qera, energji elektrike, ujë, shpenzime mirëmbajtjeje, shpenzime për materiale kancelarie, blerje librash etj. <p>Mbi bazën e këtyre shpenzimeve janë llogaritur edhe tarifat e shkollimit për të gjitha programet dhe nivelet e studimit.</p>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	<p>Raporti financiar është hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të UV, dhe paraqet informacion në rang institucioni. Atje specifikohen të ardhurat nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucioni: tarifa shkollimi e regjistrimi, qera, shitje shërbimesh, subvencione etj. • Nga buxheti i shtetit (grantet e MASR) <p>për vitet: 2017, 2018, 2019. 25-30% e të ardhurave vijnë prej institucionit ndërsa pjesa tjetër vjen prej buxhetit të shtetit.</p> <p>Këto të ardhura përdoren prej UV në financimin e :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) paga e sigurime shoqërore për burimet njerëzore, bursa studentësh, 2) mbështetje e kërkimit shkencor, 3) organizime konferencash, 4) shpenzime operative :për qera, fatura energjie e uji, material 5) blerje librash e material didaktike për laboratore etj.

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 2019, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 44

	6) Shpenzime ekspeditash të studentëve etj. Të dhënat për të ardhurat sipas viteve detajohen në Akt-Rakordimet e UV me Degën e Thesarit Vlorë.			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Raporti financiar është bërë çdo vit dhe pasqyron burimet financiare të UV. Gjithashtu detajohet sipas viteve edhe përdorimi i financimeve për paga, bursa, shpenzime operative, shpenzime për mbështetjen e stafit akademik në pjesmarrje konferencash etj. Raporti mbahet në nivel institucioni, me të dhëna të pandara sipas 4 fakulteteve. Për një vlerësim më real të kostove të programeve të studimit, del e nevojshme që kontabiliteti të mbahet mbi bazë njësie kryesore ose njësie bazë. Kjo do të bënte një orientim më efektiv drejt programeve të studimit që kërkon tregu i punës ose kanë prioritet kombëtar ose lokal dhe mbylljen e programeve të studimit që nuk justifikojnë shpenzimet.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Raportet financiare janë hartuar në fund të çdo viti kalendarik. në dosjen e akreditimit janë paraqitur raportet financiare për 3 vitet e fundit. Këto raporte paraqesin në tabela të dhëna krahasimore në lidhje me planifikimin dhe faktin e shpenzimeve për çdo zë. Diversifikime të mundshme të financimeve janë bërë me qëllim garantimin e ecurisë së programeve të studimit dhe mbarëvajtjen e tyre.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Në rang institucioni, UV dëshmon përmes Akt-Rakordimeve mbi të ardhurat, se përveç tarifave të shkollimit ka edhe burime të brendshme financimi, që emërtohen si “të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve” ose “sponsorizime”, por që nuk specifikohet më tej. Këto të ardhura janë të vogla krahasuar me totalin e të ardhurave nga institucioni, maksimumi rreth 4%. Kështu që UV duhet të bëjë përpjekje për rritjen e kapaciteteve të vetëfinancimit me qëllim përmirësimin e situatës financiare dhe të mundësojë gjenerim të ardhurash për rritjen e cilësisë dhe standardeve në programet e studimit që ofron.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 2019, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

Faqe 45

<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UV zbaton politika bazuar në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet rregullatore në fuqi. Mbështetur në statutin dhe rregulloret e brendshme të të gjitha niveleve të UV, ka hartuar procedura që ndjekin zhvillimin e formimit akademik të studentëve sipas fushave të programeve të studimit nga fillimi I studimeve e deri në diplomimin e tyre.</p>			
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Përmes transparencës së informacionit, politikat dhe procedurat e zbatuara në procesin e formimit akademik të studentëve mundësojnë të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student në hyrje dhe për gjithë studentët në rrugëtimin e tyre drejt diplomimit. Pranimi i studentëve në UV bëhet pas publikimit të listave me renditjen e studentëve në 3 faza. Më pas përveç informacionit që jepet në faqen zyrtare të UV, çdo student ka mundësi që përmes adresës zyrtare të tij/saj të aksesojë sistemin UVMS dhe të përfitojë informacione shtesë sipas nevojave.</p>			
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga ana e UV shpallja e kriterëve dhe procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve në programet e studimit janë të kuptueshme dhe të aksesueshme në mënyra të ndryshme: <u>faqja zyrtare web e UV</u>, <u>statuti i UV</u>, <u>Rregullorja</u>, <u>njoftimet</u>. Gjithashtu informacioni mund të gjendet i shpallur edhe në ambientet e brendshme të fakulteteve të UV në këndet e informacionit etj. Edhe procedurat e transferimit të studimeve, ekuivalentimeve e njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme kryhet përmes komisionit që DITD ngre në fillim të çdo viti akademik për këto qëllime. Studentët mund të marrin informacion edhe në zyrën e sekretarisë mësimore dhe zyrën e studentit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në propozimet që bëjnë departamentet, Senati Akademik i UV miraton me kriteret e veçanta për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe i bën ato publike përmes formave të ndryshme të njoftimit. Në hartimin e kriterëve për përzgjedhjen dhe pranimin e kandidatëve, departamenti bazohet në udhëzimet e MASR dhe Maturën Shtetërore.</p>			
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Senati Akademik i UV miraton propozimet dhe kuotat e DITD në lidhje me kriteret e përzgjedhjes dhe pranimit në programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”. Këto propozime bazohen tek Udhëzimet e MASR në lidhje me kriterin e notës mesatare për ciklin e parë të studimeve si dhe në kapacitetet e UV FSHT në lidhje me kuotat. Kuotat parashikojnë pranimet nga vendi, trojet shqiptare, nga jashtë vendit, komunitetet e pakicat si dhe personat me aftësi të kufizuara, statusi jetim. Parashikohen edhe kuota për transferim studimesh dhe program të dytë studimi.</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzohet publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara se të fillojë periudha e plotësimit të formularëve të aplikimit prej maturantëve, Staf i UV merr pjesë në aktivitete promovuese në gjimnazet e rrethit të Vlorës ku përfaqësuesit e departamenteve japin informacion në lidhje me ofertën didaktike e formuese të programeve të studimit. Në këto takime marrin pjesë edhe studentë aktualë që ndajnë përvojën e tyre. Si mjete promovuese përdoren edhe rrjetet sociale e televizionet lokale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentët e marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik në mënyra të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Duke konsultuar në faqen zyrtare web të UV dokumenta si Statuti, rregulloret etj. • Në takimet e para me pedagogët e lëndëve, ata njihen me programin e lëndës, detyrimet që duhet të përmbushin për futjen në provim, • Mënyrat e vlerësimit, riprovimeve, kalimi në vitin pasardhës etj • Procedurën e diplomimit etj. • Duke u konsultuar me zyrën e studentit, sekretarinë mësimore etj.
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Përmes dokumentave bazë si Statuti i UV, dhe Rregulloret që aksesohen online, studentët marrin informacion të mjaftueshëm për procedurat e njohjes së studimeve të mëparshme ose transferimit të studimeve. Për informacion më të detajuar, studenti drejtohet edhe në zyrën e studentit, sekretarinë mësimore ose departamentin përkatës. Departamenti ngre komisionin dhe kryen procedurën e ekuivalentimit të krediteve për njohjen e studimeve të mëparshme, transferimit të studimeve ose në rastin kur studentët kanë kryer mobilitete përmes programeve e marrveshjeve që UV ka me universitetet jashtë ose brenda vendit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të fituara prej tyre gjatë zhvillimit të programit të studimit. Ky informacion merret në mënyra të ndryshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nga rregullorja e DITD dhe rregullorja e programit të studimit, që aksesohen në faqen zyrtare web të UV. 2) Nga pedagogu i lëndës 3) Nga sekretaria mësimore. <p>Këto informacione janë në përputhje me specifikimet e bëra në syllabuset e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kritere dhe procedura janë përcaktuar qartë edhe për punimin e diplomës dhe provimin e formimit. Këtë informacion studentit e merr nga rregullorja e DITD, rregullorja e diplomimit dhe rregullorja e programit të studimit. Studenti diplomohet në 2 mënyra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Me punimin e një teme diplome, nëse studentit ka mesatare më të madhe se 9. Nëse nuk ka studentë që plotësojnë këtë kusht, atëherë 3 studentët me mesatare më të lartë mund të marrin temë diplome prej DITD. Punimi i Diplomës duhet të plotësojë kushtet që specifikohen në rregulloren e diplomimit.

	2) Me provim formimi , nëse ka mesatare më të vogël se 9. DITD jep informacion në lidhje me temat orientuese të provimit.			
	Informacioni merret edhe në sekretarinë mësimore ose DITD.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	UV në mënyrë periodike para plotësimit të formularit të aplikimit prej maturantëve, organizon takime promovuese me gjimnazet e Qarkut Vlorë dhe me gjerë. Gjithashtu organizon aktivitete e takime të hapura, ditët e informimit të maturantëve si dhe përgatit udhëzues, fletëpalosje në ndihmë të informacionit për maturantët. Në këto aktivitete angazhohen anëtarët e departamenteve, anëtarë të drejtorisë së Edukimit të ciklit I e II, zyra e këshillimit të Karrierës e Alumni etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informacionin për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, çdo student në UV e merr në faqen zyrtare web të universitetit, e merr në takimin e parë informues në fillim të studimeve , por mund ta marrë edhe prej pjesës së stafit të dedikuar punës me studentin në nivel UV ose FSHT.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga takimi me studentët doli e qartë se informacioni që ata kanë nevojë të marrin në lidhje lëndët, modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese merren gradualisht prej pedagogëve të lëndës por edhe në mënyrë të plotë mund të merren prej informacionit në zyrën e studentit, nga sistemi informativ UVMS ose në faqen zyrtare.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	UV organizon çdo vit Panairin e punës, ku studentët dhe përfaqësues nga biznesi lokal mund të takohen për të identifikuar ofertën që ka tregu aktual i punës. Gjithashtu edhe pedagogët e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” me njohjet dhe rekomandimet e tyre shërbejnë si një urë lidhëse midis bizneseve apo subjekteve shtetërore që zhvillojnë aktivitetin në fushën e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike apo me subjekte që zhvillojnë aktivitet në fushën e industrisë.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	UV me anë të sistemit të menaxhimit dhe informimit, në kanalën “studentët” gjejnë informacionin e përditësuar për të cilin ata kanë nevojë në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën etj. Nga ana tjetër prej faqes zyrtare web apo edhe në standat informuese merret informacioni për infrastrukturën dhe shërbimet e UV në lidhje dhe në funksion të procesit mësimor.
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet	Sistemi i menaxhimit të brendshëm UVMS, që jep informacione të përditësuara në lidhje me procesin mësimor të gjithë programeve të

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 2019, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 48

permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	studimit, është i aksesueshëm prej studentëve nëpërmjet llogarisë personale të tyre të krijuar prej UV dhe që është aktive që në fillim të studimeve dhe për sa kohë gëzon statusin student. Duke qenë se është një sistem që mund të aksesohet on-line dhe në distancë, bëhet lehtësisht i aksesueshëm dhe shumë i dobishëm për studentët e gjithë programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve															
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Nga materiali i paraqitur prej UV në dosjen e akreditimit, është e qartë se institucioni mban statistika vjetore (mbi bazë vitesh akademike) në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, të ç’regjistruar, si dhe raportin përkatës meshkuj/femra në çdo program studimi.															
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Tabelat e përpiluara nga Drejtoria e studimeve të nivelit I dhe II kanë informacion statistikor të detajuar, mbi bazë vitesh akademike, në lidhje me studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të regjistruar në çdo program studimi • Të diplomuar në çdo program studimi • Të tërhequr ose të larguar para përfundimit të programit të studimit , ç’regjistruar etj , në çdo program studimi <p>Të dhënat për këtë program studimi janë:</p> <table border="1" data-bbox="718 1310 1316 1518"> <thead> <tr> <th>Numri i studentëve të regjistruar</th> <th>Për herë të parë</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017-2018</td> <td>50</td> <td>7.48</td> </tr> <tr> <td>2018 -2019</td> <td>41</td> <td>7.54</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>40</td> <td>7.65</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>50</td> <td>8.21</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga të dhënat duket se në këto vite është në rritje nota mesatare e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Por mbetet evidente nevoja e rritjes së përpjekjeve prej DITD që për programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” të tërhiqen në vazhdimësi studentë me notë mesatare në rritje me qëllim që cilësia e produktit në dalje të jetë në nivelin e kërkesave të tregut të punës.</p>	Numri i studentëve të regjistruar	Për herë të parë	Nota mesatare	2017-2018	50	7.48	2018 -2019	41	7.54	2019-2020	40	7.65	2020-2021	50	8.21
Numri i studentëve të regjistruar	Për herë të parë	Nota mesatare														
2017-2018	50	7.48														
2018 -2019	41	7.54														
2019-2020	40	7.65														
2020-2021	50	8.21														
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Sekretaria mësimore e UV disponon të dhënat në lidhje me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit, ecuri e cila reflektohet në 3 regjistra:															

	<ol style="list-style-type: none"> 1) Regjistri themeltar, ku secili student i regjistruar ka të dhënat personale si dhe numrin e matrikullimit të dhënë prej MASR. 2) Regjistrin e arritjeve akademike, ku për secilin student pasqyrohen vlerësimet me notë për secilën lëndë të programit mësimor 3) Regjistrin e të diplomuarve. <p>Këto të dhëna ruhen edhe në format elektronik përveç se fizik.</p>								
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit UVMS mundëson aksesimin dhe verifikimin e informacionit për studentët dhe ecurinë e tyre në programin e studimit në mënyrë të lehtë por të sigurtë, duke u mbështetur në parimin e konfidencialitetit dhe ruajtjes së të dhënave personale.								
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Nga materialet në dosjen e akreditimit, del e qartë se analizat vjetore në nivel departamenti apo institucioni trajtohet midis të tjerave dhe profili i studentëve të regjistruar si dhe cilësia e tyre në hyrje dhe dalje të programit të studimit. Nga ana e DITD bëhen përpjekje për rritjen e cilësisë së studentëve në hyrje përmes promovimit të UV në gjimnazet e qarkut Vlorë, por ende kërkohet shumë punë për arritjen e qëllimit në këtë aspekt.</p> <p>Gjithashtu trajtohet edhe cilësia e studentëve në përfundim të programit të studimit që reflektohet tek cilësia e punësimit të tyre. Nga takimi me specialistët e zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, u pranua që informacioni me studentët e diplomuar pas punësimit të tyre është i pakët, përpjekja e UV për mbajtjen e lidhjeve nuk ka qenë tepër efektive, dhe po bëjnë përpjekje që kjo mangësi informacioni të recuperohet në vazhdimësi për studentët e diplomuar së fundmi.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në zbatim ligjit 80/2015 dhe në mbështetje të Statutit të UV, studentët kanë të drejtë të jenë pjesë e vendimmarrjes në të gjitha nivelet. Ata kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik, të zgjedhur përmes një procesi zgjedhor në rang institucioni. Nga ana tjetër Këshillat Studentore janë krijuar mbi bazë njësie kryesore dhe nga ana e UV tentohet që studentët të bëhen pjesë e gjithë komisioneve.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të	Nga takimi me stafin akademik dhe studentët si dhe bazuar në dokumentacionin e dosjes së akreditimit, mund të konfirmojmë se në UV studentët përfshihen në vendimmarrje përmes përfaqësuesve të zgjedhur prej tyre në nivele të ndryshme të institucionit (Senat Akademik, komisione etj, ku diskutohen çështje të rëndësishme si:

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 2019, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 50

jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Buxheti i UV, adresimi i kërkesave të studentëve etj.). Studentët gjithashtu marrin pjesë sistematikisht në vlerësimin e procesit akademik, në pyetësin për procesin akademik që zhvillohet 2 herë në vit, nëpërmjet shprehjes së mendimeve të tyre dhe këshillimit e sugjerimit për përmirësimin e punës. DITD merr parasysh vërejtjet dhe komentet e dhëna në pyetësor duke i bërë pjesë të diskutimit në departament me qëllim që rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Ky proces e bën vendimmarjen e studentëve jo vetëm të matshëm por edhe të frutshëm.			
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.	Në UV, procedurat e përparimit të studentëve përgjatë zhvillimit të programit të studimit apo ato të njohjes së studimeve të pjeshme ose të plota, bazohen në aktet rregullatore të brendshme dhe zbatohen konform kornizës logjore në fuqi. Nga ana e DITD bëhet përpjekje që procedurat të mos jenë burokratike por të ndihmojnë integrimin e studentëve në programet e studimit thjesht dhe me transparencë. Kjo arrihet nëpërmjet përfshirjes së studentëve në komisionet ad-hoc që departamentet krijojnë në këtë proces. Nga ana tjetër ngarkesa akademike e studentëve të inxhinierisë elektrike synohet të alternohet dhe balancohet midis leksioneve, seminareve e praktikës. Maksimumi i ngarkesës mësimore në auditor është 25 orë/javë.			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Pyetësi i çdo fundsemestri që UV organizon, dhe marrja parasysh e mendimit të tyre në planin e masave, garanton që pjesëmarrja e studentëve në rishikimin e programeve të studimit të jetë reale.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Nga takimi me studentët u bë e qartë se atyre u jepet mundësia të kërkojnë të drejtën e tyre në lidhje me vlerësimin e kontrollit të dijeve mbi baza barazie, ndershmërie dhe që respekton të drejtën e ruajtjes së të dhënave personale. Atyre u jepet mundësia e ankimit, e rishikimit të provimit dhe rivlerësimit nga komisioni i paanshëm. Kjo procedurë është e shpjeguar në rregulloren e programit të studimit dhe zbatohet me rigorozitet nga stafi akademik. Nga ana tjetër ata mund të shprehin mendimin e tyre në pyetësorët, në rubrikën që ka lidhje me barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me	Në Statutin e UV njihet e drejta e studentit për informim dhe në rregulloret e brendshme të DITD dhe programit të studimit “bachelor në Inxhinieri Elektrike” shpjegohen procedurat, që institucioni përmes stukturave

parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	specifike që ka ngritur, garanton shërbim mbi bazë barazie dhe konform akteve rregullatore të UV.			
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në UV janë në funksionim struktura që kanë si detyrë kryesore dhënien e informacionit, orientimin dhe shërbimet ndaj studentëve. Përveç sekretarisë mësimore, Drejtoria e Edukimit të ciklit I dhe II me sektorët e saj : <ul style="list-style-type: none"> • Sektori i kurrikulës dhe shërbimit ndaj studentëve • Sektori i këshillimit të karrierës dhe Alumni, ndjekin në vazhdimësi ecurinë e studentëve dhe i informojnë ata në lidhje me çështje të zhvillimit të programit të studimit.			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në Drejtorinë e Edukimit të ciklit I dhe II në UV, njëri prej sektorëve në shërbim të studentëve është Zyra e Këshillimit të karrierës dhe Alumni, e cila angazhohet në mënyrë periodike për dhënien e informacionit të nevojshëm në rrugëtimin e studentëve prej fillimit e deri në përfundim të programit të studimit. Informacioni që kjo njësi jep, ka rëndësi në lidhje me orientimin e tyre në procesin mësimor, praktikën profesionale, si dhe në mbështetjen e institucionit për integrimin e shpejtë dhe efektiv në tregun e punës.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga takimi me specialistët e kësaj zyre u evidentua përpjekja e vazhdueshme që bëhet prej UV në ndjekjen e karrierës së studentëve të diplomuar në UV. Por u pranua se për shumë të diplomuar lidhjet kanë humbur për arsye të ndryshme (largim nga qyteti, shteti etj) dhe statistika për ecurinë profesionale të studentëve të diplomuar nuk është e plotë. Nga diskutimi me këtë njësi, u evidentua nevoja e intensifikimit të përpjekjeve për krijimin e një database me të dhënat e ecurisë profesionale të të diplomuarve, që do të ishte promovimi më efektiv i programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UV mbështetur në Statutin e tij dhe në funksion të arritjes së misionit, zbaton politika në përputhje me ligjin 80/2015 me qëllim rritjen e cilësisë së produktit të programeve të studimit që zhvillon.</p> <p>Për garantimin dhe sigurinë e cilësisë, UV ka ngritur një strukturë të posaçme që operon sipas akteve rregullatore të brendshme dhe në përputhje me kornizën ligjore e nënligjore në fuqi.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sipas dokumentacionit në dosjen e akreditimit dhe takimeve në institucion, UV ka ngritur dhe ka funksionale Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila funksionon në nivel institucioni dhe me përbërje nga të gjitha njësitë kryesore. Qëllimi kryesor i kësaj njësie është zbatimi i strategjisë së UV për rritjen e vazhdueshme të cilësisë, duke vlerësuar periodikisht procesin akademik, financiar dhe administrativ, proces ku përfshihen: stafi akademik, stafi ndihmës akademik, ekspertë të jashtëm dhe studentët.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Me qëllim arritjen e rezultateve më të mira, Senati Akademik ka miratuar vendimin për ngritjen e Njesive të Sigurimit të brendshëm të Cilësisë edhe në nivel Njësie Kryesore. Sipas takimeve me specialistët e kësaj strukture, këto komisione nuk janë funksionale, por nga ana e institucionit shihet e nevojshme vënia në funksion e tyre dhe përfshirja edhe e ekspertëve të huaj me qëllim rritjen e nivelit të punës në këtë aspekt.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Nga ana e NJSBCVI në UV bëhen përpjekje të mira për të zbatuar politikën e hartuara nga institucioni dhe përkthimit të tyre në procedura periodike për rritjen e cilësisë së programeve të studimit që UV ofron. Përmes rregulloreve, përmirësimit të vazhdueshëm të formës dhe përmbajtjes së pyetësorëve, si dhe ndërveprimit me studentët, kjo njësi synon krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional dhe ndërgjegjësimin e përfshirjen e gjithë faktorëve dhe aktorëve të brendshëm të institucionit, pasi vetëm kështu garantohet arritja e misionit të UV.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>UV ka ngritur njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë, pasi ato paraqesin një pjesë të rëndësishme në zinxhirin e formimit të kadrove të ardhshëm në gjithë fushat. Kjo njësi është Drejtoria e Edukimit të ciklit I dhe II, ku një prej sektorëve është: Sektori i kurrikulave dhe mbështetjes së studentëve. Në këtë proces jep kontribut edhe NJSBCVI si dhe Zv.Dekani i Fakultetit.</p>

	Nga ana tjetër, vetë DITD ka qenë iniciatore e përmirësimit të programit të studimit bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, ndryshimet e të cilit janë miratuar me Vendimin Nr.43 datë 12/07/2018 të Senatit Akademik të UV, dhe ka hyrë në fuqi për vitin akademik 2018-2019.			
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Nga ana e UV përdoren mekanizma e procese formale që dokumentohen në lidhje me shqyrtimin, ndryshimin, miratimin e programeve të studimit të ciklit të parë, ndër të cilët përmendim: <ul style="list-style-type: none"> • Raportet e NJSBCVI për pyetësorët e studentëve • Raportet e DITD dhe Njësisë kryesore FSHTN • Analiza e punës hartuar prej Drejtorisë së edukimit të ciklit I dhe II si dhe propozimi që kjo drejtori i bën Senatit Akademik për ndryshimet në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” konform kritereve e akteve ligjore në fuqi • Organizimi i Workshopit ku në fokus është studenti dhe tregu i punës, me qëllim përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e pritshmëritë e tij (tregut të punës). 			
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	UV përmes Senatit Akademik ka miratuar krijimin e dy instrumentave që vlerësojnë ecurinë e programeve të studimit në nivel institucioni: <ol style="list-style-type: none"> 1) Pyetësorin e studentëve për cilësinë e mësimdhënies nga stafi akademik 2) Pyetësorin e studentëve për cilësinë e shërbimeve të dhëna prej stafit administrativ. Metodologjia e përpunimit të të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve të pyetësorëve bazohet kryesisht në të dhënat sasiore.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Raporti final me rezultatet e pyetësorëve të studentëve hartohet prej NJSBCVI, e cila e bën vlerësimin mbi bazë programesh studimi. Ky raport i dërgohet zyrtarisht Njësisë Kryesore e Njësisë Bazë, të cilat e bëjnë raportin objekt të diskutimit në department, me qëllim përmirësimin e punës në funksion të mendimeve e sugjerimeve të studentëve.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Nga ana e DITD, pas diskutimit të raporteve me rezultatet e anketimit të studentëve, hartohet një plan masash me qëllim adresimin e mangësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ky plan masash raportohet dhe në Rektorat ku pritet miratimi prej Senatit Akademik në lidhje me masat e propozuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë	Në parim, vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit bëhet periodikisht prej IAL-ve, por programi i studimit “bachelor në Inxhinieri

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 2019, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 54

<p>periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Elektrike vetëvlerësohet prej NJSBCVI të UV për herë të parë. Nga ana e kësaj njësie dhe Grupit të Vlerësimit të Brendshëm është përdorur :</p> <ul style="list-style-type: none"> • rezultati i anketimeve periodike të studentëve, • raportet e DITD në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor, • kërkesën që tregu i punës ka në lidhje me produkte të çertifikuara , në këtë rast, me programe studimi të akredituara <p>që kanë shërbyer si bazë për vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit.</p>			
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vetëvlerësimit, UV dhe DITD kanë përdorur instrumentat e unifikuar për të gjitha programet e studimit: pyetësorin e studentëve dhe më pas procedurën në departament për adresimin e problematikave, propozime që miratohen në Senat pas diskutimeve në Rektorat. Për natyrën specifike që mund të ketë programi i studimit “bachelor në Inxhinieri Elektrike” nuk dokumentohet ndonjë instrument specifik për marrjen e indikatorëve për kryerjen e vetëvlerësimit.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UV ka si praktikë vetëvlerësimi në lidhje me cilësinë e programit të studimit përdorimin e metodës së drejtpërdrejtë duke marrë mendimin e studentëve për performancën e stafit akademik, vlerësimin e mësimdhënies e didaktikës. Për vlerësim më të plotë të cilësisë së programit të studimit, DITD duhet të përdorë edhe metoda të tjera me qëllim matjen e treguesve për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerësimin e kurrikulës, • ushtrimi i kontrollit të brendshëm për mënyrën e zhvillimit të leksioneve/seminareve/laboratoreve, • testime të ndryshme lokale ose ndërinstucionale të standardizuara etj. 			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>UV dhe NJSBCVI përdorin edhe metoda të tërthorta në kuadër të vetëvlerësimit të cilësisë së programit të studimit “bachelor në Inxhinieri Elektrike”. Konkretisht :</p> <ul style="list-style-type: none"> • organizimi i workshop-it “studentët dhe tregu i punës”, përmes takimit të sipërmarrësve, studentëve të diplomuar dhe stafit akademik e studentëve, jep një opinion të besueshëm në lidhje me cilësinë e programit të studimit. <p>Nga ana e NJSBCVI, dhe sektorit të këshillimit të karrierës dhe Alumni, duhet të punohet më shumë për krijimin e databazës me studentët e diplomuar dhe ecurinë e tyre profesionale. Nga ana tjetër, edhe krijimi i një forme statistikore të standardizuar për marrjen e mendimit të stafit akademik e administrative, do të ndihmonte në vetëvlerësimin e programit të studimit në një mënyrë më të plotë e nga më shumë këndvështrime.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.4**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga ana e UV përmes akteve rregullatore të brendshme përshkruhen procedura në frymën e politikës së institucionit për sigurimin e cilësisë duke përfshirë aktorët e brendshëm si: stafi akademik, stafi administrativ e studentët. Me qëllim krijimin e një kulture për vetvlerësim të brendshëm real e të dobishëm, duhet që këto akte rregullatore të modifikohen me qëllim përfshirjen edhe të aktorëve të jashtëm të interesuar drejtpërdrejt në cilësinë e produktit që jep programi i studimit “bachelor në Inxhinieri Elektrike”, siç mund të jenë përfaqësues nga biznesi dhe titullarët e stafeve teknike të ndërmarrjeve që operojnë në fushën e inxhinierisë elektrike të industrisë apo energjitikës.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në aktet rregullatore të brendshme të UV, në të gjitha nivelet, ka detyra konkrete të përcaktuara në lidhje me të gjitha palët që janë aktorë dhe faktorë në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Në këto rregullore përshkrimi i detyrave specifike për seicilin pozicion pune, garanton edhe ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Duke vlerësuar procedurën që ndiqet prej NJSBCVI dhe DITD për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, vihet re se në vetvlerësimin e cilësisë së tij përfshihen: <ul style="list-style-type: none">• njësia bazë e njësia kryesore me raportin për planin e masave e propozimet për adresimin e problemeve• anëtarët e stafit akademik e administrativ si subjekt i vlerësimit• studentët, si pjesë e palës që jep vlerësimet Kjo gjithpërfshirje garantohet prej procedurës së vlerësimit të sanksionuar në rregulloret e ndryshme.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Vlerësimi i brendshëm përfshin të gjithë aktorët e brendshëm dhe në këtë proces që kryhet periodikisht nga UV, respektohet liria akademike dhe integriteti i çdo individi duke shmangur çdo lloj diskriminimi. Ky parim barazie i shprehur si frymë e politikës së ndjekur nga institucioni në gjithë procesin, konfirmohet edhe nga stafi e studentët në takimet me ta
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Për vlerësim real dhe efektiv të programit të studimit, është i nevojshëm edhe mendimi i aktorëve dhe ekspertëve të jashtëm. Në praktikën e UV, kjo konsiston në takime me biznesin lokal në workshop-in “Studentët dhe tregu i punës”. Do të ishte më e dobishme që veç aktiviteteve të këtij lloji të merreshin mendime edhe nga ekspertë të jashtëm në fushën akademike.

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 2019, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.alE-mail: info@ascal.al

Faqe 56

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në të drejtën për informim, UV bën të ditur politikën, strategjinë, dhe veprimtaritë që institucioni organizon në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Këto informacione seicili student apo staf i UV mund t'i aksesojë në faqen zyrtare web të UV, ku gjen legjislacionin bazë si Statutin, Kodin e Etikës, Rregulloret e UV, fakulteteve, Departamenteve, programeve të studimit, raporte, vendime të Bordit të Administrimit etj. Gjithashtu gjenden edhe njoftimet për aktivitetet akademike e sportive,			
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBCVI publikon raportet e vlerësimit të programit të studimit dhe i shpërndan ato në Njësitë kryesore e Njësitë bazë. Këto raporte hartohen duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, ruajtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin. Diskutimi i rezultateve në departamente nuk ka qëllim dënimin e pjesës së stafit që shfaqin problematika por marrjen e treguesve për aspektet e punës akademike që kanë nevojë për rishikim.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Pas diskutimit të rezultateve të pyetësorëve të studentëve në departament, ky I fundit harton një raport me propozime për planin e masave që adreson problematikën dhe e dërgon në rektorat dhe për miratimi në Senatin Akademik. Qëllimi kryesor në këtë proces është plotësimi i mangësive dhe dobësive të evidentuara.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Gjithë procesi i vlerësimit të cilësisë dhe efektivitetit të programit të studimit ka një impakt të konsiderueshëm, pasi rezultatet e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe plani i masave i propozuar dhe miratuar, pasqyrohet në planet e punës së departamenteve. Procesi është periodic, dhe bëhet 2 herë Brenda 1 viti akademik.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga ana e UV organizohen takime të stafit akademik e studentëve ku NJSBCVI dhe Drejtoria e Edukimit të ciklit I dhe II informojnë dhe ndërgjegjësojnë ata në lidhje me rolin që kanë në rritjen e cilësisë së programit të studimit në terma afatgjatë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “në Inxhinieri Elektrike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Në qarqet e Shqipërisë së Jugut nuk ka universitete me program studimi të ngjashëm me “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”, si rrjedhim mund të përfitojë në tërheqjen e studentëve relativisht më të mirë me interes në këtë fushë.
2. UV ka ndërtuar struktura institucionale me përkushtim të lartë në drejtim të promovimit të programeve të studimit.
3. UV ka realizuar marrëveshje me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit duke krijuar mundësi të mira mobiliteti për stafin akademik dhe studentët.

Pika të dobta:

1. Numri i panjaftueshëm i laboratoreve për programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri elektrike” pasi një pjesë e lëndëve të formimit profesional nuk kanë mundësi zhvillimi të aspektit praktik në auditor por zhvillohen si eskursione mësimore.
2. Cilësia relativisht e ulët e studentëve në hyrje të programit të studimit, megjithëse në vitin e fundit akademik 2020-2021 ka një rritje, dhe që DITD duhet të përpiqet që kjo rritje të jetë e qëndrueshme.
3. Mungesa e stafit akademik të ftuar minimizon mundësinë e përfitimit prej eksperiencës së tyre praktike në sektorë me interes për programin e studimit.
4. Stafit akademik efektiv duhet të jetë më aktiv në drejtim të kërkimit shkencor.
5. Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” nuk ka vazhdimësi në ciklin e dytë të studimeve në UV.

Rekomandime:

1. UV duhet të shikojë mundësinë e investimeve në lidhje me ngritjen e laboratorëve për lëndë të formimit profesional si: Transmisione elektrike, makina elektrike, elektronikë fuqie etj. Laboratorët bashkëkohorë që duhen ngritur dhe marrëdhëniet me subjekte lokale që menaxhojnë objekte me teknologji të avancuar, do të krijojnë mundësi më të mira për zhvillimin e kërkimit shkencor.
2. UV duhet të gjejë mundësitë për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik efektiv si një domosdoshmëri për rritjen e cilësisë në mësimdhënie.
3. UV duhet të tentojë rritjen e cilësisë së studentëve në hyrje të programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor "in Electrical Engineering" of the University "Ismail Qemali", Vlora

Strengths and affirmations:


1. There is no University that offers the first level study program "Bachelor in Electrical Engineering", in the region of Southern Albania. Therefore UV can benefit in attracting relatively better students with interest in this field.
2. UV has built institutional structures with high commitment in terms of promoting study programs.
3. UV has realized agreements with counterpart institutions inside and outside the country, creating good mobility opportunities for academic staff and students.

Weaknesses:

1. The number of laboratories dedicated to the study program "Bachelor in Electrical Engineering" is few. For this reason the laboratories of some professional courses of the study program can not be realized.
2. The low quality of students that follow this study program. DITD should continue with efforts to do more attractive the study program in order to have better quality of students to follow it. The reorganization of study program on 2018 has shown first results in the academic year 2020-2021, where the quality of student is increased a little bit.
3. The lack of invited academic staff minimizes the possibility of benefiting from their practical experience in sectors of interest for the study program.
4. Effective academic staff should be more active in terms of research.
5. The study program "Bachelor in Electrical Engineering" has no continuity in the second cycle of study programs as Professional Master or Master of Science in this field at UV.

Recommendations:

1. UV should look at the possibility of investments related to the establishment of laboratories for the professional courses such as: electric machines, electrical measurements. Electrical drives, power electronics, etc. The modern laboratories that need to be set up and the relations with local entities that manage facilities with advanced technology, will create better opportunities for the student to be employed as soon as they can in field of Electrical Engineering..
2. UV should find opportunities for further qualification of effective academic staff as a necessity for increasing the quality of teaching
3. UV should try to increase the quality of students at the entrance of the study program "Bachelor in Electrical Engineering" through more professional laboratories and scientific books in accordance with labor market needs.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

